



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

P R O C E S V E R B A L

I M B L E D H J E S S Ë G J A S H T Ë T Ë K U V E N D I T T Ë K O M U N Ë S S Ë V I T I S Ë

Mbledhjen e ftoi kryetari, z.Bekim Azizi, kryesues i seancës së Kuvendit Komunal. Mbledhja është mbajtur më 29.05.2026 (e premte), në shtëpinë e kulturës “Gursel e Bajram Sylejmani”, duke filluar punë në orën 10:00. Në mbledhje morën pjesë kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, nënkryetari i Komunës, z.Hasan Aliu, drejtorët komunal, mediat elektronike, si dhe këshilltarët e Kuvendit: z.Basri Aliu, z.Ramadan Deliu, zn.Zejnepe Osmani, z.Illir Zuka, z.Ekrem Ymeri, z.Faruk Shabani, znj.Yllka Qamili, zn.Djellza Fejzullahu, z.Bekim Azizi, z.Hajdin Ademi, z.Visar Demiri, z.Nuhi Ramadani, z.Selim Sejdiu, znj.Elsa Jahija, znj.Ardita Hajdari, zn.Mirjeta Hamiti, z.Jakup Demiri, zn.Lindita Demelezi, zn.Majlinda Shabani, z.Ekrem Abazi, z.Lulzim Haxhiu, zn.Liridona Bislimi, z.Remzi Salihu dhe z.Elham Emërllahu. Ndërsa munguan, z.Sokol Shaqiri, z.Bekim Rama dhe z.Labinot Bislimi.

Kryesuesi i Kuvendit, Bekim Azizi: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e pestë të rregullt. Përshëndetje për të gjithë të pranishmit që janë në këtë seancë. Kjo është seanca e gjashtë e Kuvendit Komunal të këtij mandati. Shfrytëzoj rastin t’ju uroj festën e Kurban Bajramit dhe t’ju uroj hapjen zyrtare të fushatës, duke ju uruar kandidatëve nga Vitia suksese dhe një fushatë të mirë, të qetë dhe të ndershme. Para se me fillu me rendin e ditës, unë po e shoh që janë vendosë disa letra para neve. Është e rendit që çdo qytetar që vjen në kuvend, para se me hy në zyrë të kuvendit, duhet të konsultohet me mua dhe të diskutojmë kush janë dhe për çfarë arsye janë vendosë këto. Po e shohim që është një revoltë, por duhet të konsultohemi para se me hy, sepse ky është rendi. Megjithatë, ne jemi pjesë e këtij vendi dhe do të vazhdojmë me punime. Gjatë kësaj periudhe kemi një pjesë të akteve të ligjshmërisë të miratuara në Kuvendin Komunal, të cilat nuk na janë kthyer nga seanca e fundit. Gjithashtu, një çështje që e kemi më herët dhe që e kemi në rend të ditës sot, për binjakëzimin me Komunën e Saint-Julien, nuk ka qenë shumë e harmonizuar me pjesën e formatit dhe ajo pjesë na është kthyer të shqyrtohet edhe një herë. Nuk ka asnjë ndryshim nga ajo që kemi miratuar herën e parë; është e njëjta. Mirëpo, ka qenë një lëshim për shkak se ministrisë nuk i është dërguar me kohë në tri gjuhë, siç është dashur të dërgohet. Gjuha frënge ka qenë pjesë e këtyre tri gjuhëve. Materialin e keni marrë me kohë dhe vazhdojmë te rendi i ditës.

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së pestë të Kuvendit Komunal.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e raportit të komisionit për përgatitjen e draftdokumentit për ndryshim-plotësim të Statutit të Komunës së Vitisë, me Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit përfundimtar për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit përfundimtar për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për kompaninë kosovare për distribuim dhe furnizim me energji elektrike sh.a KEDS në Viti, për vendosjen e trafave elektrike.

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për kompaninë kosovare për distribuim dhe furnizim me energji elektrike sh.a KEDS në Viti, për vendosjen e trafave elektrike.
7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për plotësimin e Vendimit Nr.01-110/05-381, të datës 31.03.2026 për miratimin e marrëveshjes së binjakëzimit mes Komunës së Vitisë dhe Komunës së Saint Julien en Genevois – Francë.
8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të viti 2025 në vitin 2026.
9. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për vizitë studimore në Shqipëri.
10. Informatë nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për Manifestimin Tradicional Kulturo-Sportiv "Flakadani i Karadakut 2026".
11. Pyetje dhe përgjigje.

Kryesuesi i Kuvendit, Bekim Azizi: Hapi debat për rendin e ditës.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Përhëndetje të nderuar të pranishëm. Edhe unë ju uroj festën e Kurban Bajramit dhe urime hapjen e fushatës, me dëshirë që kjo fushatë të shkojë në formën më të mirë të mundshme, ashtu si kanë ditur qytetarët e Komunës së Vitisë. Besoj se edhe këtë herë kanë me e kalu në formën më të mirë të mundshme. Kryesues i Kuvendit Komunal, me siguri e ke edhe ti një ankesë, të cilën na e kanë drejtuar qytetarët e fshatit Devaj. Pas ankesës e ke të nënshkruar nga ana e kryesisë së fshatit prej pesë anëtarëve dhe ke një petition të nënshkruar nga 74 qytetarë të fshatit Devaj. Unë e di se Kuvendi Komunal ka aprovuar një listë për dhënie në shfrytëzim të pronave. E di se ish-përbërja e Kuvendit Komunal i ka kaluar edhe procedurat nga aspekti ligjor të shpalljes së ankandit publik. Kanë konkurruar dhe është bërë edhe ndarja, ndërsa sot jemi te vendimi përfundimtar, të cilin e kanë materialin edhe kuvendarët, e ke edhe ti, kryesues. Megjithatë, si ekzekutiv në këtë rast, si nënkryetar i Komunës së Vitisë, pavarësisht si mundeni ju me e kuptu këtë çështje, pavarësisht kush janë ata qytetarë, edhe pse në këtë rast ka koiciduar që unë jam edhe nip i Devajës, kjo nuk ka lidhje. Në çdo lokalitet ku është në pyetje një petition, unë do t'u bashkëngjitem qytetarëve të cilët e kanë nënshkruar petitionin. Dhe në këtë rast, kryesues, të propozoj që dy vendimet, të cilat janë pikat 3 dhe 4, për momentin të pezullohen dhe me të vërtetë çështjen e revoltës së qytetarëve të Devajës ta kuptojmë në formën më të drejtë të mundshme. Unë e di se kjo është në dorën tuaj dhe të kuvendarëve, por megjithatë propozimi është në të mirën e gjithë qytetarëve dhe konsideroj se do t'i kishte bërë nder çdo këshilltari të Kuvendit Komunal, por edhe vetë fituesit të pronës, nëse kjo çështje bëhet me mirëkuptim. Çështjet të cilat bëhen me revoltë, sidomos te bashkëkombësit tanë, unë këto çështje nuk do t'i dëshiroja kurrë, jo vetëm në këtë lokalitet, por edhe në shumë lokalitete të tjera. Prandaj, duke pasur parasysh edhe gjendjen, unë sot propozoj që këto dy pika të hiqen nga rendi i ditës. Pres mirëkuptimin tuaj, zoti kryesues.

z.Elham Emërllahu: Në saje të rendit të ditës, të nderuar të pranishëm, në cilësinë e asambleistit të Kuvendit Komunal, pa ndonjë tendencë politike, kërkoj nga Kuvendi Komunal i Vitisë sot, ose të paktën të hidhet në votim si pikë e rendit të ditës, që të nxirret një deklaratë publike, nëse është nevoja edhe politike, kundër një rasti që ka ndodhur dje nga Policia e Kosovës ndaj dy familjarëve të dëshmorëve të kombit. Konkretisht ndaj djalit të komandantit Njazi Azemi – Komandant Mjekrra. Policia e Kosovës, pa vetëdije dhe pa bazë ligjore, sepse jam konsultu mbrëmë dhe sot edhe me ekspertë, por edhe me ish-zyrtarë të policisë, nuk ka ndonjë bazë ligjore për me u dënu për simbolin më emblematic të lirisë dhe pavarësisë sonë, të UÇK-së. Dje u bë e madhe kjo çështje dhe sot ka rastis që ky kuvend me pasë seancë. Dy djem të dëshmorëve janë dënuar në Prishtinë për shkak se kanë pasur simbolin e UÇK-së të vendosur në tabelat e veturave. Ne të gjithë e kemi nga një simbol në veturat tona, edhe në familje, edhe në shtëpi, edhe në setër e mbajmë, dhe nuk ka askund të shkruar që ndalohet me mbajt një simbol për të cilin për neve është shumë i lavdishëm. Djali i komandantit Njazi Azemi është simbol i familjes heroike. Krejt Komuna e Vitisë, Anamorava, Kosova dhe gjithë shqiptaria krenohen me luftën heroike të komandantit Njazi Azemi dhe të djalit të dëshmorit Bislimi. Andaj, kërkoj nga ky kuvend që sot ta nxjerrim një deklaratë në kundërshtim të këtij veprimi të Policisë së

Kosovës. Nuk kam asgjë kundër policisë; ata policë ose nuk kanë qenë të informuar, ose kanë qenë të shtyrë nga një faktor që unë nuk e di, por veprimi i djeshëm ka qenë i rëndë për ne si qytetarë.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Unë mendoj që Inspektorati i Policisë duhet gjithsesi të merret me këtë rast dhe me shkeljet që janë bërë. Ne, si kuvend, dënojmë çdo akt të tillë, ku dënohen njerëzit për simbole të vlerave të luftës dhe të çfarëdo vlere kombëtare.

z.Basri Aliu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Edhe unë ua uroj festën e Kurban Bajramit të gjithë besimtarëve myslimanë. Pasi sot është Dita Botërore Kundër Duhanit, po shfrytëzoj rastin të bëj thirrje në kuvend që ta respektojmë si ditë dhe të pimë duhan më pak. Ndërsa te rendi i ditës, ne si grup parlamentar i LDK-së vazhdojmë me pikat e rendit të ditës, të cilat i kemi dhe të cilat kanë kaluar në KPF, ndërsa për çështje tjera diskutohet brenda këtyre pikave.

z.Visar Demiri: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Ne, si grup parlamentar i PDK-së, kërkojmë që të vazhdohet me të gjitha pikat që kanë kaluar në KPF. Ato i kanë kaluar të gjitha procedurat ligjore dhe jemi në rregull me rendin e ditës.

z.Jakup Demiri: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Ne, si grup parlamentar, nuk kemi qenë pjesë e shumë muhabetëve. Nuk dojmë të përziemi hiq në këtë punë, se edhe ashtu po besoj se nuk kemi ndonjë efekt.

znj.Majlinda Shabani: Përshëndetje për të gjithë. Fillimisht dua ta përmend një rast, për të cilin po besoj që gjithsecili keni dëgju për dje. Është fjala për një aksident i cili ka përfunduar me fatalitet, ku ne kemi humbë një bashkëvendës, bacin Zaim. Unë dua t'i shpreh ngushëllime në emrin tim, por edhe në emrin e Kuvendit Komunal, familjes dhe gjithë fshatit Lubishtë. Gjithashtu, dua të bëj apel tek të gjithë qytetarët që të kenë kujdes në komunikacion dhe me shpejtësinë. Apeloj te të gjithë që të kenë kujdes, sepse raste të tilla nuk duhet të na ndodhin. Sa i përket çështjes që edhe nënkryetari e përmendi, po edhe unë sot, si asambleiste e Kuvendit Komunal, natyrisht që nuk do të qëndroj e heshtur karshi kësaj proteste, po e quaj simbolike, të qytetarëve që janë sot prezent. E dimë që Kuvendi Komunal parimisht funksionon dhe është i të gjithë qytetarëve, dhe gjithsecili qytetar e ka të drejtën e vet me e shpreh revoltën në forma të ndryshme. Kemi pasë diskutime mjaft të gjata sa i përket pronave që i kemi pasë si pika për me kalu, por në situatën që jemi dhe duke marrë parasysh disa rrethana, ku edhe shefi i grupit tonë parlamentar e përmendi, unë pajtohem që kjo pikë duhet me u shty. Pajtohem plotësisht me kryetarin; nuk është në rregull. Dhe nuk besoj që i bën nder qoftë investitorit që me ardhë dhe me kalu kjo pikë kështu, pa ra në një dakordancë me këta qytetarë. Këta qytetarë janë të atij vendi, këta jetojnë e punojnë aty çdo ditë dhe natyrisht që flasin në emër të fshatit dhe e kanë të drejtën e plotë. Gjithashtu, unë për vete i kam dyshimet e mia, sepse i dimë edhe praktikën, qoftë prej situatave të kaluara që kemi pasë me këto prona. Për mua, paraprakisht më e udhës është që të diskutohen dhe të shterren të gjitha debatet, qoftë për atë investim, qoftë për mënyrën se si është duke u bërë, qoftë për interesin. Më e rëndësishmja për mua është që natyrisht duhet me pasë edhe një pëlqim prej anës së ministrisë, nëse është tokë e cila konsiderohet që është për me u bërë ai investim i tillë. Unë jam me qytetarët e këtij komuniteti që kanë ardhë këtu dhe janë duke protestu në mënyrë simbolike, dhe pa arritë dakordancë me ta, nuk jam që Kuvendi Komunal me ua mohu këtë të drejtë.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka më për diskutim, ne kemi dy pika për të cilat është kërkuar nga nënkryetari të largohen nga rendi i ditës. Këto pika janë shqyrtuar në KPF dhe kemi kërkesë nga grupet që të vazhdohet me rendin e ditës të njëjtë. Unë detyrohem me i qitë në votim.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Unë jo rastësisht po kërkoj nga ana jote, si kryesues i Kuvendit Komunal, që këto dy pika mos me u fut në rend të ditës. Unë nuk kam të drejtë me thanë se jam më shumë se ti apo më shumë se secili këtu që është. Nuk dua asnjë përçarje mes bashkëkombasve të mi; konsideroj që të njëjtën "lëkurë" e kemi të gjithë. Duke pasë parasysh këtë, asgjë më urgjente se jeta e njeriut nuk ka. Vetëm jeta e njeriut kërkon nganjëherë urgjencë e shpejtësi për me intervenu e me shpëtua jetë. Kjo çështje nuk kërkon asnjë urgjencë; ka pritë 7–8 muaj për shkak të zgjedhjeve. Prandaj konsideroj që duhet me hasë në mirëkuptimin tuaj që kjo çështje mos me u votu si pikë e rendit të ditës. Pse po e them këtë? Gjithçka që bëhet në përputhje me marrëveshje me të gjithë faktorët relevantë që janë të përfshirë, do ta ketë edhe suksesin më vonë. Ndërsa gjithçka që shkon në formë kur një palë e kundërshton, linden çështje që ndoshta më vonë është problem me u

riparu. Prandaj, ne si dy organe më të larta, duke fillu prej ekzekutivit dhe Kuvendit, që është organi më i lartë që e kryeson ti, duhet me pasë gjithmonë në konsideratë këtë. Pikerisht për këtë kemi marrë besimin, jemi këtu dhe kemi dhënë betim. Prandaj, shumë herë e kam përserit në fushatë dhe zgjedhje: mua si personalitet, si individ, as fitimi i zgjedhjes e as fitimi i një prone nuk vlen sa një qytetar. Nëse një qytetari i rrjedh gjak nga hunda, mua nuk më pëlqen ajo – nuk e dua atë. Prandaj, konform kësaj ishte lutja ime në fillim dhe është edhe tash kërkesa ime: është në dorën tuaj. Ditët në thes nuk janë hy, mundemi me u ulë, me shku me bisedu, nuk është larg, shkojmë çdo ditë. Nuk është problem me u formu delegacione prej Kuvendit dhe Ekzekutivit, me bisedu, me e shtu çështjen, me e sqaru çfarë projekti ka me u zhvillu aty, me marrë miratimin e komunitetit. Nuk kemi problem. Ju jeni ata që mundeni me vendos. Përndryshe, në rast se i ke 74 nënshkrime, që i konsideroj shumë legjitime, dhe i ke edhe 5 nënshkrues të këshillit të fshatit – këshilli i fshatit është i zgjedhur dhe i monitoruar nga ky Kuvend – nuk është me rëndësi kush ka qenë në atë përbërje; është me rëndësi që vjen nga ky Kuvend dhe nga ekzekutivi. Nëse nuk e marrim parasysh këtë, konsideroj që i bëjmë dëm institucioneve. Unë jam idhtar i mbrojtjes së institucioneve deri në fund, prandaj për me i mbrojt duhet me u marrë vendime të drejta. Nuk po them që ata me peticion kanë të drejtë apo ne jo, por duhet me shku me bisedu, me ua qit hallin banorëve dhe me sqaru cili është qëllimi. Kur e ke mirëkuptimin e tyre, besoj që edhe projekti zhvillohet më mirë ose, nëse duhet, nuk zhvillohet fare. Edhe unë konsideroj që ti ke përvojë në këtë drejtim dhe besoj që do ta kesh në konsideratë këtë kërkesë time, duke pasë parasysh që duhet me i pasë në mendje edhe këshilltarët e Kuvendit Komunal. Jeta nuk është një mandat – po jua them – jeta është përtej një mandati. Pikerisht për këtë po e them.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Unë pajtohem me atë që je tu thanë, sepse i kemi këtu komplet me revoltë, me krejt. Mirëpo edhe ti e din që unë jam kryesues i Kuvendit dhe kam një votë, ndërsa anëtarët e Kuvendit janë ata që vendosin për punën, për procedurat, për zhvillimet dhe për të gjitha këto. Prandaj, me varet prej meje, ndoshta unë hiq nuk e kisha prurë në këtë seancë, për shkak që ka pasë procese zgjedhore; e kishim shty për më vonë. Mirëpo po kërkon një pjesë e anëtarëve të Kuvendit me vazhdu tash. Parimisht, unë e thirra edhe Zyrën Ligjore në MAPL për këtë situatë, edhe ata më sugjerun që kërkesa për tërheqjen e pikës duhet të trajtohet në Kuvend, që me votë të largohet nga rendi i ditës.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Mua më vjen mirë që ke thirrë Zyrën Ligjore. Unë kam thirrë edhe dje edhe pardje, jo këtë Xhevat Tafën, por tjetrin, dhe sipas informacioneve që na i kanë dhënë, kemi dy informacione të kundërta. Mua më kanë thënë se në rast se propozuesi dhe kryesuesi janë dakord, kanë të drejtë me e tërheq pa e qitë në votim. Kështu më është thënë.

z.Elham Emërllahu: Unë e pata një propozim, kryesues. Nuk është qaq e thjeshtë. Ajo që e kam bërë unë është edhe në lidhje me pikën time të propozuar. Sot në mëngjes kam taku edhe Shoqatën e Dalë nga Lufta, edhe po vi prej takimit me ta në Viti, bashkë me z. Idriz Quni dhe të tjerë. Është mirë me pyet Kuvendin a me e futë në rend të ditës për nxjerrjen e asaj deklarate, ku Skenderbeg folë Lul Nuh Ramadani. Me iu jep shans asamblistëve me u deklaruar, a janë për, a janë kundër, a janë të gatshëm me e shti në rend të ditës atë kërkesë që e pata unë si Kuvend Komunal, për me u dënu djali i dëshmorit për një gjë shumë të kotë, që nuk e ka pengu as simbolin e as emblemën e shtetit. Kjo është tepër skandaloze. Prandaj kërkoj prej teje, si kryesues, që atë propozim që e pata me e qitë në votim te asamblistët dhe me nxjerr një deklaratë si Kuvend Komunal kundër atij veprimi. Në të kundërtën, unë nuk kam çka qëndroj në sallë.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Faleminderit, Elham. Unë për këtë kam hapë diskutim. Për këtë jemi në pikë të rendit të ditës. Nuk e kemi miratuar ende deklaratën, ndërsa deklaratat miratohen me pëlqimin e grupeve parlamentare. Për këtë, domethënë, në fund, kur të miratohet rendi i ditës dhe ky propozim, krejt shqyrtohet dhe hyn. Për këtë, një deklaratë nuk miratohet nga tre veta, por nga krejt, me pëlqimin e grupeve parlamentare. Pastaj bëhet teksti dhe ai tekst miratohet dhe bëhet siç është.

z.Elham Emërllahu: Deklarata mundet me u bë brenda ditës, brenda seancës, nëse është nevoja thirret edhe seancë e jashtëzakonshme.

z.Skenderbe Hebibi, drejtor i Drejtorisë për Administratë: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Edhe pse situata qenka më e komplikuar për shkak të rendit të ditës dhe asaj që tha Elhami, që ma përmendi emrin,

unë, Elham, jam deklaruar dje. Unë personalisht, domethënë si qytetar i Kosovës, kush i prek emblemat e UÇK-së, qoftë edhe Policia e Kosovës, ka punë me armë me mu personalisht, sikur që i kam dalë zot gjatë luftës edhe pas luftës. Kush i prek emblemat e UÇK-së, unë ja kthej me përgjegjësi – kjo është deklarata ime, ndesh le të jetë LDK, ndesh PDK, ndesh VV, nuk ka kush i prek emblemat e UÇK-së. Rëndin dhe ligjin e ka shteti dhe ligji ku do. Ky është mendimi im personal, nuk ka lidhje me parti.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Shkojmë në pauzë. Të nderuar anëtarë të Kuvendit, ekzekutiv, qytetarë të nderuar, pas kësaj pauze që bëmë dhe pas konsultimit edhe me anëtarët e grupeve dhe anëtarët e Kuvendit Komunal, duke pasqeruar parasysh kërkesën e qytetarëve dhe të nënkryetarit, por duke pasqeruar parasysh edhe procedurat e Kuvendit që janë kaluar deri tash, jemi në një pozicion të tillë që po e shohim të gjithë. Atëherë, unë si kryesues i Kuvendit, pas të gjitha konsultimeve, për t'i dhënë hapësirë aspektit ligjor dhe për t'i respektuar qytetarët që janë këtu në sallë, seancën me të gjitha pikat e mbylлим sot. Kjo seancë do t'i japë hapësirë rreth dy javë, deri në përfundim të zgjedhjeve, dhe të koordinohet aspekti ligjor për këto pika. Më pas do të vazhdojmë me seancë të re. Pra, seanca për sot mbyllet dhe pezullohen të gjitha pikat deri pas zgjidhjes të kësaj çështje. Faleminderit të gjithëve për kontributin e dhënë në këtë seancë. Mirupafshim në seancën e radhës.

Sekretaria: Mbledhja përfundoi me punë në ora 11:30 min.

Sekretaria: Vazhdimi i seancës së gjashtë të Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhjen e ftoi kryetari, z.Bekim Azizi, kryesues i seancës së Kuvendit Komunal. Mbledhja është mbajtur më 30.06.2026 (e Martë), në shtëpinë e kulturës “Gursel e Bajram Sylejmani”, duke filluar punën në orën 10:00. Në mbledhje morën pjesë kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, nënkryetari i komunës, z.Hasan Aliu, drejtorët komunalë, mediat elektronike, si dhe këshilltarët e Kuvendit: z.Basri Aliu, z.Ramadan Deliu, zn.Zejnepe Osmani, z.Illir Zuka, z.Ekrem Ymeri, z.Bekim Rama, znj.Yllka Qamili, zn.Djellza Fejzullahu, z.Bekim Azizi, z.Hajdin Ademi, z.Visar Demiri, z.Nuhi Ramadani, z.Selim Sejdiu, znj.Elsa Jahija, znj.Ardita Hajdari, zn.Mirjeta Hamiti, z.Jakup Demiri, zn.Lindita Demelezi, z.Ekrem Abazi, z.Lulzim Haxhiu, zn.Liridona Bislimi dhe z.Remzi Salihu, z.Elham Emërllahu, z.Labinot Bislimi., ndërsa munguan: z.Faruk Shabani z.Sokol Shaqiri, znj.Majlinda Shabani, Liridona Bislimi.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në vazhdimin e seancës së gjashtë, të ndërprerë më 29.05.2026, dhe sot po vazhdojmë aty ku e kemi lanë. Ndërsa, pas kësaj seance vazhdojmë me seancën e re në bazë të materialit që keni marrë. Duke e pasqeruar parasysh që pjesën e parë e kemi diskutuar atë ditë shumë te rendi i ditës, rrethanat e ndërprerjes së seancës ishin të qarta, pasi kemi qenë prezentë të gjithë në kuvend. Pas shumë diskutimeve gjatë kësaj periudhe për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale në Devaj, njëri nga operatorët, i cili ka qenë përfitues, DAKA Grup, ka bërë një shkresë Kuvendit Komunal dhe kryetarit të komunës që të hiqet nga interesi për marrjen në shfrytëzim të investimit në atë zonë, ndërsa për operatorin tjetër nuk kemi ndonjë informatë. Prapë, në këtë seancë kemi disa qytetarë këtu dhe disa janë jashtë. U koordinum që të mos hyjnë në sallë me numër të madh. Me kërkesën e kryetarit të komunës, pika 3 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, pas dorëheqjes së DAKA Grup, tërhiqet prej rendit të ditës. Kryetari kërkon që të hiqet nga rendi i ditës edhe pika 4, propozim për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale tjetër, ndërsa, në konsultim me operatorin tjetër që është fitues dhe me qytetarët, në kuadër të kësaj kemi tërheqjen edhe të pikës për propozim-shqyrtimin dhe miratimin e draft-ndryshimit të Statutit të Komunës së Vitisë për këtë seancë, që të vazhdohet në seancat e radhës. Pika 8, për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin 2026, është mbajtur me seancë të jashtëzakonshme. Kjo pikë veç është e përfunduar në atë seancë, me datën 15. Pas propozimit të kryetarit për largimin e pikave 2, 3 dhe 4, atëherë unë kërkoj që të miratohet rendi i ditës dhe të vazhdojmë me seancën. Pasi që është kërkesë e kryetarit, kërkoj që të miratohet rendi i ditës me tërheqjen e pikave që u çekën. Pra, me 17 vota pro, 4 abstenime dhe 1 kundër, miratohet edhe rendi i ditës. Pasi që u miratua rendi i ditës, për këtë seancë kemi përpara këtë rend të ditës.

R e n d d i t e

12. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së pestë të Kuvendit Komunal.

13. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për kompaninë kosovare për distribuim dhe furnizim me energji elektrike sh.a KEDS në Viti, për vendosjen e trafave elektrike.
14. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për kompaninë kosovare për distribuim dhe furnizim me energji elektrike sh.a (KEDS) në Viti, për vendosjen e trafave elektrike.
15. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për plotësimin e Vendimit Nr.01-110/05-381, të datës 31.03.2026 për miratimin e marrëveshjes së binjakëzimit mes Komunës së Vitit dhe Komunës së Saint Julien en Genevois – Francë.
16. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për vizitë studimore në Shqipëri.
17. Informatë nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për manifestimin tradicional kulturo-sportiv "Flakadani i Karadakut 2026".
18. Pyetje dhe përgjigje.

Kryesuesi i Kuvendit, Bekim Azizi: Si pikë e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së pestë të Kuvendit Komunal

z.Jakup Demiri: Nuk hape debat hiq për rendin e ditës.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Ne veç në seancën që kemi mbajtur u diskutu për atë pikë. Tash janë tërheqë pikat dhe janë kry. A ka dikush vërejtje për procesverbalin? Pasi që nuk ka për debat, a jeni që të miratohet procesverbali? Nga të gjithë të pranishmit pro, pa asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim, miratohet procesverbali.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për kompaninë kosovare për distribuim dhe furnizim me energji elektrike sh.a KEDS në Viti, për vendosjen e trafave elektrike

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Para se të hy në këtë pikë të rendit të ditës, ta bëjë një faleminderim kompanic DAKA Grup për mirëkuptimin që ka pasë mes egzekutivës, qytetarëve dhe tërheqjen që ka bërë. Tash te propozimi në fjalë. Është fjala për zonën kadastrale në Goshic dhe ne kemi pasë mirëkuptimin. Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrit e ka bërë punën e vet, e kemi këtu edhe qertifikatën, por e ka edhe ndarjen që ka bërë dhe keni propozim-vendimin ju, të gjithë kshiltarët e Kuvendit Komunal. Për atë nuk po e lexoj, por megjithatë jemi në përputhje, apo në koordinim të plotë edhe me kërkesën e qytetarëve dhe kërkesën e KEDS-it që qytetarët tonë të kenë mjaftueshem energji elektrike dhe ne, konform kompetencave tona, t'i kryem obligimet tona.

z.Labinot Bislimi: Atë që tha Jakupi, që po i ikim prap debatit lidhur me investimet në Devaj, por sido që të jetë, meqenëse u përmend DAKA Grup, kjo kompani u tërheq në mënyrë të ndershme dhe ka qenë korrekte dhe serioze përgjatë gjithë këtij procesi. Mua më është dokë e vetmja kompani serioze prej tjerave dhe, në të ardhmen, ta ruajm si favorit për investime, të cilat do të jenë në përputhje me energjin dhe ruajtjen e mjedisit. Një mbarje mend për ta ruajt si investitor të ardhshëm.

z.Basri Aliu: Përshëndetje për të gjithë pranishmit. DAKA Grup, ju faleminderona, dhe unë. Por duhet ta kemi parasysh që vendimet apo propozimet që vinë në Kuvend duhet të shqyrtohen mirë, që të mos delë Kuvendi para aktit të kryer, sepse po i bjenë se sikur me presion po largohen këto pika. Sa i përket KEDS-it, gjithmonë është interes i qytetarëve dhe ne ta kryejm punën tonë, mandej KEDS-i i ka tjerat. Por unë po e shfrytëzoj rastin, sepse dje pata kërkesë nga qytetarët për në Drobesh, i cili është përcaktu vendi. E di që komuna nuk ka të bëjë me këtë qeshtje, por publikisht KEDS-it t'i kërkojm që ato pozicione ku ja kemi leju për me investu, kishte qenë mirë që edhe investimet t'i bëjë sa më shpejt, në mënyrë që qytetarët të kenë energji elektrike.

z.Elham Emërllahu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Edhe unë ju bashkohem kolegëve që çështjet e rëndësishme, të cilat vinë në Kuvendin Komunal, ose ne kemi të miratuar një plan të punës vjetor të Kuvendit Komunal, edhe siduket nuk jemi tu e përmbush, por mos me thanë jemi tu deviju prej programit dhe punës të

miratuar për vitin 2026. U përmend DAKA Grup, e cila ka qenë çështje e nxehtë, por nuk u përmend arsyeja pse është tërhek DAKA Grup, dmth duhet me pas një arsyetim, sepse ka qenë fitues edhe kompania tjetër. Por realisht, pa ndonjë debat, me u hekë pikat e rëndësishme të rendit të ditës, edhe çështja e Statutit nuk e di pse është tërhek. Ndoshta edhe nuk i ka pas numrat koalicioni, por është një çështje që është diskutu shumë për Statutin dhe është dashtë me procedu për rend të ditës. Prandaj nuk duhet me ra në pre të presionit e interesave të ndryshme që me deviju një pikë të rendit të ditës. Qe dy herë e shtym pikën e rendit të ditës kur është fjala për dhënie në shfrytëzim të pronave në Devaj. Nuk po them as me kalu, as jo, por janë çështje me interes të përgjithshëm. Prandaj mua më duket që, pa ndonjë debat, pa ndonjë diskutim konkret, se veç ka kërku kryetari me tërhek dhe tash ne duhet me tërhek, kjo nuk më duket mua mirë. Ne, si Kuvend, nuk jemi tu e kry punën mirë.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Pikat që propozohen prej kryetarit, para miratimit, mundë me i tërhek. Nuk është hekë pas miratimit. Pas miratimit e tërhekim me votim. Ne, para miratimit, mundë me i tërhek. Kjo është rregull, si në Qeveri, si këtu. Mundë me u tërhek për arsyet që i ka ekzekutivi. Mua më vinë sikur juve propozimet dhe plani i Kuvendit është gati 100% që realizohet, ndërsa këto pika që vinë jashtë planit, sipas kërkesave apo procedurave që zhvillohen. Edhe diskutimi, ju lutem, të bëhet për pikën që jemi tu diskutu.

z.Labinot Bislimi: Një pyetje për kuriozitet. Kur the për një pikë e cila nuk miratohet, dmth para se me u miratu mundet me u tërhek, kjo pika në fjalë a ka qenë e miratuar në seancën e kaluar? Dhe pajtohem me parafolsin që temave të mëdha nuk guxojm t'ju ikim. Se për punën e trafos krejt jemi dakord.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Jo, sepse nuk e kemi miratu rendin e ditës.

z.Ilir Zuka: Përshëndetje për të gjithë pranishmit. Patjetër që jam pro për trafo, por a ka mundësi me na sjellë një informatë për krejt këto prona që kemi ndarë për trafo: a u vendos ndonjë prej tyre? Se disa i di unë që i kemi ndarë një kohë të gjatë, e di që nuk kanë vendos trafo. E tjetra, për shkak që po ndërlihet me KEDS, e lus egzekutivin me diskutu me ta. Shpiat e reja që kyqen në KEDS shkojnë prej 3–6 muaj, nuk munden me hy banorët në shtëpi të reja për shkak që ju vonohet kyqja në KEDS. Kjo është një kërkesë e disa qytetarëve që presin me muaj KEDS për kyqje dhe nuk po shkojnë me u kyq.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Besoj se në takimin të cilin e kam pasë dhe kërkesat e tyre që kanë qenë pranë meje, përshkak se e dini që kompania KEDS është e privatizuar, planin e tyre të cilin ma kanë tregu më kanë thanë se ka kalu trafo në Goshic dhe Kabash. Ato të cilat i kam pasë informacionet prej ish-drejtorit Basries, e kam ngrit qeshtjen e Drobeshit dhe e kam pasë informacionin që është një trafo në gjysë në Ramjan, të cilën kam kërku që të dyat të përfundojn. Në rast se doni bashkëpunim të mirëfilltë mes komunës, se sikur ne që po i kryejm obligimet tona edhe ata t'i kryejn, janë zotu që kanë me i kry. Sipas tyre, çdo vonesë e jona mundë që trafot me kalu në ndonjë komunë tjetër. Pikërisht për këtë jam obligu, kam bë edhe kërkesë telefonike në drejtori që me dalë me i caktu parcelat dhe me u vendos qeshtja e trafove në dy lokalitetet të cilat kanë kalu. Por kërkesa ime e vazhdueshme është që të kryhet Drobeshi dhe Ramjani.

z.Jakup Demiri: Nënkyetar, më herët kur i kemi dhanë disa parcela për KEDS-in kemi parapa që edhe ata me pasë obligime ndaj atyre parcelave. A janë zbatu ato? Dhe prej 3 lokaliteteve që kanë pasë më së shumti probleme me energji elektrike ka qenë lagjia te Xhamia, fshati Drobesh dhe një lagje e Smirës. A ka ndonjë dakordim me ta që këto që kanë probleme më së shumti me pasë prioritet, mandej me ardh te zonat tjera? Se ne jemi komunë, nuk mundemi me ndiku shumë, por si orientim me pasë KEDS-i që këto janë prioritetet, se janë keq me rrymë, ndodh që edhe TV të mos ua çon rryma. Dihet se ka pasë edhe protesta për këto.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Kërkesat e tona si ekzekutiv janë shumë më të mëdha se këto që i kanë aprovu. Megjithatë, drejtori i tyre, në takim që ka qenë, ka thënë që për këtë vit momentalisht është kjo. Prandaj kërkesa e Smirës, Skifterajt, që janë shumë keq, një pjesë janë kërkesa permanente tonat që kanë buru nga qytetarët, që janë drejtu dhe që shumë herë kanë shku edhe përmes drejtorit të Shërbimeve Publike, se në bazë të asaj drejtorie shkojnë kërkesat. Megjithatë, miratimin e kanë pas këto dy lokalitetet. Binduni që indikacionet tona si komunë janë shumë më të gjëra, por kanë kalu veç këto dy, dhe t'ju vijë radha edhe tjerave. E di që Skifterajt e kërkojnë qe 10 vite. E di për Smirën, Drobeshin etj. Ilir, për një çështje që e shtrova, ma bëre me dije që ta diskutoj në takimin e ardhshëm. Megjithatë, nuk mundemi ne me i ndryshu rregullat e tyre,

por me shtrur këtë temë pse bëhet vonesa për njërin që ka mbaruar shtëpi edhe tre muaj i vonohet kyçja apo legalizimi i orës, që me hy në KEDS, do ta kemi si çështje.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Ne zakonisht, më herët, ka qenë një procedurë. Në bazë të kërkesave të qytetarëve, ne shpesh kemi nda parcelat dhe kemi bërë kërkesa tona, i kemi bërë kërkesë KEDS-it. Tash, KEDS, kur të vendos me bërë një trafo, e lajmëron komunën për lokacion dhe komuna i cakton pikat për trafo. I bjenë në Kuvend, dmth me kërkesë të KEDS-it bëhen këto. E qes në votim këtë pikë. Nga të gjithë të pranishmit: pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, miratohet edhe kjo pikë.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për kompaninë kosovare për distribuim dhe furnizim me energji elektrike sh.a KEDS në Viti, për vendosjen e trafave elektrike

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Edhe kjo është e njëjtë, veç lokacioni është për Kabash. E njëjta kërkesë, për një ditë i kanë bërë dyjat. Konsideroj që edhe kjo meriton miratimin.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka për debat, e qes në votim këtë pikë. Nga të gjithë të pranishmit: pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, miratohet edhe kjo pikë.

Si pikë e katër e rendit të ditës:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për plotësimin e Vendimit Nr.01-110/05-381, të datës 31.03.2026 për miratimin e marrëveshjes së binjakëzimit mes Komunës së Vitisë dhe Komunës së Saint Julien en Genevois – Francë

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: E dimë se këtë propozim-vendim e kemi të miratuar në Kuvend në muajin mars, mirëpo pas disa problemeve teknike ministria e ka kthyer, se nuk është i plotësues në bazë të kërkesave të tyre. Pas konsultimeve që janë bërë nga stafi i komunës, ata veç e kanë protokollin vendimin. Na kanë thanë të njëjtin vendim me e protokollin dhe me e dërgu në tri gjuhë.

z.Fatlum Demiri, sekretar i Kuvendit Komunal: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Ashtu si tha kryesuesi, në vendimin e kemi dërgu në MAPL. Megjithatë, ministria ka kërku që marrëveshja të jetë në katër gjuhë: gjuhën frënge, angleze, shqipe dhe serbe. Megjithatë, ne e kemi dërgu, por e kemi dërgu me vonesë. Pas dërgimit që kemi bërë ne, ata kanë kërku me bërë shqyrtimin e ligjshmërisë dhe e kemi sjellë prap me bërë plotësimin e marrëveshjes, se marrëveshja është në rregull. Megjithatë, proceduralisht duhet ta bëjmë një plotësim të vendimit.

z.Basri Aliu: Për këtë pikë kemi diskutu në KPF, nuk kam qashtje tjetër, por e pyes ekzekutivin se kanë pas me 20 me qenë atje me nënshkru këtë marrëveshje. Cila është arsyeja që nuk kanë shku me datën 20 atje? Mos është kjo arsyeja apo diçka tjetër, sepse prej Shoqatës Ilira kam pas një bisedë dhe më kanë thanë që nuk janë të njoftuar pse nuk kanë qenë me atë datë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Ka qenë në bisedë shefi i kabinetit, i cili i ka njoftu dhe, mesa di, e kanë lanë shtatorin në koordinim me ta. Nuk e di muajin saktë, por vetëm me një datë tjetër që do të jetë kryetari, që ta bëjë nënshkrimin e marrëveshjes.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka për debat, a jeni që të miratohet ky propozim-vendim? Nga të gjithë të pranishmit: pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, miratohet edhe kjo pikë.

Si pikë e pestë e rendit të ditës:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për vizitë studimore në Shqipëri

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Kemi propozu një vizitë studimore dhe vizitë të Kuvendit, me koordinimin e shëfave të grupeve dhe pjesës së ekzekutivit, dmth koordinim në kohën shtator ose tetor me bërë një vizitë studimore. Kërkesa, çka na vjen deri atëherë, që duhet patjetër me pasë një mbështetje ligjore, ta kemi një vendim të Kuvendit, për shkak se shpenzimet shkojnë prej buxhetit të Kuvendit. Kemi pasë vizita edhe më herët, është një përvojë e mirë. Kuvendet komunale nëpër Kosovë bëjnë vizita të ndryshme në shtete tjera, mirëpo për shkak të buxhetit që nuk e kemi më shumë, atëherë për Shqipëri besoj që është i mjaftueshëm.

z.Elham Emërllahu: Diçka e mire, pasi si asamblisti i ri po besoj që ka me qenë një përvojë e mirë me këto vizita studimore dhe vizita të institucioneve të Republikës së Shqipërisë. Besoj që është interes dhe e rëndësishme e interesante.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka për debat: a jeni që të miratohet ky propozim vendim? Nga të gjithë të prashnimit pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet dhe kjo pikë.

Si pikë e gjashtë e rendit të ditës:

6. Informatë nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për manifestimin tradicional kulturo-sportiv "Flakadani i Karadakut 2026"

Z.Valmir Sahiti, drejtori: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Sot prezantoj informatën rreth manifestimit të Flakadani të Karadakut 2026. Meqenëse materialin e keni marrë me kohë dhe pasi kemi dy seanca, do të mundohem të jem sa më i shkurt. Edhe këtë vit është organizuar dhe mbajtur Manifestimi Tradicional Kulturo-Sportiv "Flakadani i Karadakut 2026", si një nga ngjarjet më të mëdha kulturo-sportive që organizohet në Komunën e Vitisë, ku kanë marrë pjesë nxënës, sportistë, shkrimtarë, artistë, grupe artistike e sportive nga të gjitha trevat shqiptare, në nderim të dëshmorit të kombit, Njazi Azemi – Komandant Mjekrra. Në kuadër të manifestimit "Flakadani i Karadakut" janë zhvilluar këto aktivitete, siç është Festivali Gjithëkombëtar i Shoqërive Kulturore Artistike, Gara e Recitatorëve, Ora e Madhe Letrare, Turniri Kombëtar në Shah, Turneu Kombëtar në Basketboll, ecje hiking, shtegtimi, po ashtu janë zhvilluar edhe akademia përkujtimore dhe aktivitete tjera të rëndësishme. Në kuadër të gjithë manifestimit "Flakadani i Karadakut" kanë qenë diku rreth 1200 pjesëmarrës, të cilët kanë participuar në aktivitete të ndryshme kulturore, sportive apo letrare. Po ashtu, përgjatë kësaj informate e keni edhe raportin financiar të financimit. Kostoja totale e manifestimit për vitin 2026 është 15 mijë e 60 euro dhe i keni të ndara për të gjithë zërat buxhetorë dhe shpenzimet veç e veç. Dua ta falënderoj edhe lidërshpin institucional, të gjithë zyrtarët e Komunës së Vitisë, Kuvendin Komunal, por mbi të gjitha të gjitha grupet artistike, klubet sportive dhe gjithë të tjerët që kanë ndihmuar që organizimi i këtij manifestimi të jetë në nivel sa më të mirë dhe Vitia të paraqitet sa më dinjitetshëm para të gjitha trojeve shqiptare.

z.Illir Zuka: Një pyetje drejtorit: a keni bërë një analizë të tri datave më të mëdha në Komunën e Vitisë, Njazi Azemi, Kenan Halimi, 2 Korriku, sa është numri i shikueshmërisë të këtyre aktiviteteve?

z.Elham Emërllahu: Nuk kam asgjë kundër raportit, por ajo që ka filluar pak me më shqetësu është sepse "Flakadani i Karadakut" është njëri prej manifestimeve më të mëdha kulturo-sportive në Komunën e Vitisë dhe shqetësimi është që ka ra numri i vizitorëve, pjesëmarrësve në aktivitetet të cilat organizohen nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe nga Komuna në përgjegjësi. Ky manifestim nuk duhet me hup imazhin dhe as madhështinë e vetë, andaj Drejtoria e Kulturës dhe stafi i tij duhet me gjetë forma më atraktive edhe një PR më të madh sa i përket edhe parapërgatitjeve edhe përgatitjeve, por edhe transmetimit të aktiviteteve që bëhen gjatë manifestimit. Pra, nuk po them që ka diçka shumë të veçantë, e kam parë edhe këtë vit, por edhe vitet e kaluara, se ka një rënie të shikueshmërisë edhe të pjesëmarrjes në aktivitete të cilat organizohen në këtë manifestim. Prandaj, drejtoria është mirë me ndryshu pak edhe formën e aktivitetit dhe me shku në trend me rrethanat, kohën në të cilën po ecim.

z.Valmir Sahiti, drejtor: Secili shqetësim i juaji për ne është i rëndësishëm, sepse besoj që puna dhe orientimi i krejt këtyre bashkë është se si të dalim më mirë para qytetarëve. Ilir, rreth numrit të shikueshmërisë është e vërtetë, edhe Turniri Kenan Halimi, 2 Korriku, Begunca janë ngjarje shumë të mëdha dhe tërheqin shumë shikueshmëri. Elham, ne në vazhdimësi kemi bërë modalitete tek "Flakadani i Karadakut", që më herët ka zgjatë më gjatë. Ne kemi pa të arsyeshme me kthi në 3 ditë, pa humb asnjë aktivitet, veç janë ngjesh aktivitetet dhe janë shtu ato që i ceka më herët. Këtë vit kemi pasë 250 pjesëmarrës hiking prej krejt trojeve shqiptare. Është sfidë çështja e publikut në krejt aktivitetet tona. Natyrisht, edhe në aspektin institucional janë nganjëherë disa procedura burokratike që na i bajnë kogja të vështira me i ndjek këto trende të reja edhe të kulturës dhe marketingut. Por, brenda asaj që kemi mujtë me bë, jemi sjellë në mënyrën më të mirë të mundshme, brenda mundësive dhe rrethanave. Dua t'i falënderoj të gjithë ata që kanë qenë krahu jonë në këtë aspekt. Unë për madhështinë edhe rëndësinë e "Flakadani të Karadakut" nuk e kam ditë shumë deri sa jam bërë

drejtor i kulturës. Të jeni të bindur, kam pas raste me krejt asamblet e qytetit të Vitisë me marrë pjesë në shumë festivale në troje shqiptare. Kudo që shkon jashtë Vitisë, në krejt trojet shqiptare, në momentin që jua përmend Vitinë, fjala e parë që e përmendin thonë: “E keni Flakadanin e Karadakut”. Nuk ka mikpritje e organizim më të mirë se “Flakadani i Karadakut”, tu e krahasu edhe koston buxhetore. Ne, me marrë dhe një festival, është hasë 32 mijë euro në buxhet këtë vit për ta, e ne i kemi vetëm 15 mijë euro, duke i përfshi të gjitha aktivitetet tona.

z.Elham Emërllahu: Unë thashë që për Viti, por edhe për Anamoravën dhe më gjerë, “Flakadani i Karadakut” është njëri prej manifestimeve më të mëdha. Ka qenë që mbi 20 vite aty. Shqetësimi është që ne së bashku, por përgjegjësia kryesore është e juaja, me mendu diçka më atraktive, interesante, dhe te puna e buxhetit është çështja e drejtorisë me kërku buxhet më shumë. Nëse ai festivali në Has i paska mbi 30 mijë euro, e festivali “Flakadani i Karadakut” i ka 15 mijë euro, është çështje e juaja. Domethënë, ju duhet me planifiku dhe mu fokusu ma shumë te “Flakadani i Karadakut” si festivali më i madh në Komunën e Vitisë. Unë e di që ka edhe aktivitete të tjera kulturore, sportive, shumë mirë, por “Flakadani i Karadakut” nuk duhet me hup atë fuqinë e të qenurit manifestimi më i madh në këto treva.

z.Lulzim Haxhiu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Sa i përket “Flakadanit të Karadakut”, Elhami përmendi që ka ra shikueshmëria, mirëpo unë kisha propozu që “Flakadani i Karadakut” të bëhet “Flakadanet e Karadakut”, të përfshihen të gjithë dëshmorët, të bëhet sa më madhështor, të shtohet edhe buxheti për këtë manifestim. Edhe tubimet tjera të dëshmorëve që po bëhen çdo vit, e shumica organizohen prej familjarëve, e shumica bëhen edhe nga shkollat, të hiqen, mos të mbahen për çdo vit, por të mbahen një herë në 5 apo 10 vite, të organizohen nga Komuna, mos të organizojë si familje secili veç për çdo vit. Me pas ne përherë angazhim, çdo familjar i dëshmorit me i bë tubim, mirëpo të bëhet “Flakadani i Karadakut”, të bëhet “Flakadanet e Karadakut”, ku të përfshihen të gjithë dëshmorët dhe të përfundojnë me Ditën e Rënies së Njazi Azemit. Edhe të ndalen tubimet, se janë bërë pak edhe si të bajatshme, se ndoshta keq me thanë, por nuk dalin edhe njerëzit, se nuk kanë kohë, janë të nxanë nëpër punë. Diku kryetari mundet me marrë pjesë, diku jo, tana po ka dhe përçarje përmes familjeve të dëshmorëve. Kisha propozu që “Flakadani i Karadakut” të bëhet “Flakadanet e Karadakut”, në të të shtohet buxheti, në të të ndërpriten tubimet për çdo vit për secilin dëshmor, që të organizohen mirë dhe jo me shpenzime të familjarëve, dhe jo me familjarët me organizu një tubim.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Mendoj që sidomos shkollat që kanë emrat e dëshmorëve, ato shkolla kanë obligim çdo vit me organizu, pa përfshirjen e familjarëve, për shkak të nxënësve dhe emrit të shkollës.

z.Lulzim Haxhiu: Shkolla e dimë që e ka për obligim, por shkolla mundet me mbajtë Ditën e Shkollës, ndërsa Ditën e Dëshmorit mundet me bë vetëm homazhe, mos me pas obligim as institucionet e askush tjetër me shku me nejt te shkolla në tubim e në tubime tjera.

z.Illir Zuka: Jo rastësisht ia bëra drejtorit këtë pyetje. Kam qenë një prej tyre që kam ngritë shpesh këtë çështje, e kam ngritë edhe në mandatin tjetër si asambleist: mos të bëjmë ndarje të dëshmorëve, të gjithë dëshmorët janë të njëjtë, të gjithë dëshmorët kanë ra për një qëllim, për këtë liri që jemi tu e gzu ne, për këtë liri që po flasim ne. Qëllimi i pyetjes sime fillimisht ka qenë ajo që unë e di saktë që nuk është problem i mjeteve financiare, se jam prej vitit 2013 pjesë e institucioneve komunale të Vitisë, një kohë të gjatë si asistent i kryesuesit. Gjithë ato letra kanë ardhë dhe i kam parë edhe unë, e di sa janë hargju. Unë jam prej atyre kur ka qenë buxheti 27 mijë, 22 mijë e kështu me radhë. Në masë, në sallë ka pasë aq të pranishëm. Unë e di që 95% e familjarëve nuk kanë marrë pjesë në “Flakadanin e Karadakut”, që dihet se për çka mbahet dhe dihet që prej pasluftës deri sot. Njerëz sa bëhen në “Flakadan të Karadakut” ka pasë në finale të Kenan Halimit dhe 2 Korrikut. Këto duhet me i vendos mendjen vetes që nuk është puna veç aty, por mosorganizim i mirëfilltë, mosndarje as të subjekteve politike, as interesave personale. E kanë të gjithë një qëllim, si te Kenan Halimi e si te të tjerat. Unë pajtohem me propozimin e asambleistit nga radhët e Vetëvendosjes. Më erdhi keq që u deshë ai me ngritë këtë, e jo ne, për shkak që është edhe djali i dëshmorit. Është mirë me kqyrë ne si Kuvend Komunal me folë me familjen. Një ndër propozimet më të mira që munda me dhanë, e dha vetë ky. Mundemi me lanë mbylljen e “Flakadanit të Karadakut” me datën e rënies së Njazi Azemit dhe tamam si Viti ta organizojmë një manifestim si e meriton Komuna e Vitisë. Unë tani jam në cilësinë e administratorit të fshatit. Mua më takon

çdo vit me organizu. Ne si Pozheran kemi një dëshmor, përgjegjësi edhe e këshillit që po e organizon, përgjegjësi edhe e bizneseve që me i kërku mjetet edhe të gjitha tjerat, dhe me të vërtetë i kemi lodhë. Mendoj që është një propozim jashtëzakonisht i mirë me diskutu dhe krejt ky është qëllimi. Fillimisht e bëra pyetjen, sepse me një tubim kur 95% të familjeve të dëshmorëve nuk marrin pjesë për një manifestim, është pak e rëndë.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Çështja e “Flakadanit” është çështje e rregullume me Statutin e Vitisë. Ne kemi diskutu shumë herë, edhe në diskutim publik, dhe kemi thanë kur kemi diskutu edhe në komitet: le të diskutojnë, le të ulen, janë 3 shoqatat e dala nga lufta, le të merren vesh dhe le ta dërgojnë propozimin të koordinum prej tyre. Absolut, ne kurrë nuk e kemi diskutu këtë çështje që është pengesë te ne. Në statut është edhe Dita e Dëshmorëve të Vitisë, 5 Maji, edhe aty nuk del kush, se zakonisht i kanë mbajtur datat e veta që janë ndi më të rehatshme dhe është normale ajo.

z.Basri Aliu: Unë pajtohem me diskutimin e Lulit, sepse me të vërtetë nganjëherë me çështjen e dëshmorëve edhe po e keqpërdorim. Ne kemi caktu dhe me statut, siç the ti kryesues, Ditën e Dëshmorëve që është 5 Maji, dhe plotësisht pajtohem që shkollat munden me organizu takime mes vete e me nxënësit. Por, kur ka një karakter më të madh, në 5 apo 10 vite, shumë është në rregull që t’ia japim një vlerë më të madhe, ndërsa 5 Maji të jetë dita që të organizohet dhe t’i nderojmë dëshmorët në mënyrën më të duhur. Kjo është më mirë sesa që po shkojmë secili, edhe familjarët po kanë telashe në këtë drejtim, se edhe këta po janë të nxanë edhe me punë të tjera. Tash po e bën njëri dhe po e bën tjetri, dhe si tha dikush, mundet me marrë pjesë dikush e dikush jo, por është mirë që të gjithë me 5 Maj të jemi aty, t’i nderojmë ashtu si i ka hije dhe t’i eliminojmë disa ndasi individuale, po them.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Unë e kam diskutu edhe më herët me nënkryetarin me bë edhe një rregullore të Kuvendit për mënyrën dhe datat që institucionet duhet të bëjnë homazhe, dhe tek çështjet e manifestimit. Dihet sakt cilat data shkojnë institucionet, ndërsa datat që janë personale, atëherë mundet të shkojë shkolla, familja etj., se ata kanë me organizu përherë. Mirëpo, dita institucionale që janë përcaktu me rregullore të Kuvendit, është mirë ne me u ulë me bë një rregullore së bashku me Ekzekutivin.

z.Labinot Bislimi: Unë kam shkru me siguri i pari për këtë çështje. I keni dy shkrime të cilat janë bërë pika programore të Aleancës 2022-2023, dhe kushdo që i ka lexu, janë përmend pikërisht këto që po i flisni sot. Mua më erdh mirë që Luli i theksoi, se ka edhe legjitimitetin e plotë në këtë drejtim. Unë, përkundrazi, para se me mrri te rregullorja, mendoj që duhet me pasë një konferencë së bashku me familjet e dëshmorëve, bashkë me shoqatat e dala nga lufta dhe me të gjitha institucionet, përfshi edhe Kuvendin, me marrë një ditë të plotë, me ardh të përgatitur secili, me i shqyrtu mirë këto çështje dhe vërtet me mrri te ajo që tha edhe Basriu dhe të tjerët. Me datën 5 Maj me u mbledh krejt një herë e mirë për nderimin e dëshmorëve. Kjo na kish bë nder si Komunë dhe familjeve të dëshmorëve, por më së pari dëshmorëve vetë, se i bëjmë një nderim si i ka hije, e jo ka 50-60 herë në vit tu bë homazhe. Kjo është e teprume dhe nuk është që i bajmë më shumë nder kësaj pune tu e bë në këtë formë qysh jemi tu e bë deri tani. Unë besoj se institucionet kanë kapacitetin me thirrë një konferencë 1, 2, 3 ditore, nëse është nevoja, dhe me e rrahë këtë problem deri në fund, dhe në fund me mrri në konkluzione të caktuara, e cila pastaj bëhet rregullore. Vijnë këtu, e votojmë në Kuvend dhe i japim fund këtij, po e quaj, kaosi simbolik.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Respekt për propozimet të cilat dalin. Lab, pa dashtë me polemizu, por me dashtë me i kontribu kësaj çështjeje, për shkak ndoshta edhe vjetërsisë në institucione që kam pas luftës, një konferencë e tillë nuk është organizu në Komunën e Vitisë. Por megjithatë, a ka pas bisedime rreth kësaj dhe që në vetë statutin tash që është funksional janë të parapame? Unë konsideroj që janë përfshi bukur datat, domethënë 5 Maji – Dita e Dëshmorëve, 14 Qershori – Dita e Çlirimit, 17 Shkurti – Dita e Pavarësisë dhe 28 Nëntori. Konsideroj që këto 4 data këtu janë data të cilat e kanë sublimë vetë rënien e dëshmorëve, se dita e rënies së dëshmorit, unë konsideroj që ai e fiton pavdekësinë, ndërsa këto ditë janë ato që e prekin ndoshta krejt kontributin e tij që e ka bërë dhe për çka e ka bërë. Megjithatë, kjo nuk është respektu nga vetë familjarët, ndoshta shumë herë e ka qitë institucionin në pozitë të palakmueshme dhe është obligative pikërisht kur të formohet, të bëhet një rregullore. Në atë rregullore duhet të hapet debat dhe të shtrohen çështjet, të merren me një nen të rregullores. Propozimi i këtij djalit, se unë rrjedh prej një familje të tillë dhe shkolla e ka emrin në

Remnik, por me insistimin tim ju kam thanë jo çdo vit në kremtim. Në çdo 5 apo 10 vite, por shkolla kremton çdo vit se i ka sukseset e veta, por jo me organizu masë, me e maltretu familjen etj. Por kjo është aspekt individual. Ndoshta aspekti institucional është ajo të cilën ti e propozove. Ne e kemi të normume në rregullore të shkruar, p.sh. dita e shkollës manifestohet për çdo vit, ndërsa tubimi i karakterit më të madh do të jetë çdo 5 vite dhe kjo do të jetë e shkruar një nen tjetër për krejt shkollat të cilat e mbajnë emrin e dëshmorëve. Do të ishte respektabile. Për çështjen që ti e propozove, tentativa ka pasë të pandërprera në mesin e tyre dhe unë nuk e kemi mrrë atë që e propozove, që të jetë “Flakadanet e Karadakut”. Megjithatë, statutin do ta keni në seancat e ardhshme. Do të ishte mirë, pa u prek askush, të përfshihen të gjithë, se nuk ka asnjë kuptim për mua të jetë “Flakadani i Karadakut” kur mungojnë familjet e dëshmorëve shumë herë. E themi vetë, me shku me pyet dëshmorin, do të thoshte: “Unë jam me shokë”. Megjithatë, këtu është fillu tash në fillim nga vullneti i madh, ndoshta nga mosdija adekuate e kanë kanalizuar atë dhe tash nuk po janë në gjendje me kuptu me kalu këtë. Ne individualisht si shqiptarë kemi qenë gjithmonë të fortë, por kolektivisht gjithmonë kemi qenë të dobët. E kemi dëshmu në çdo etapë. Prandaj, kërkimi i kolektivitetit unë konsideroj se do të jetë madhështia që do ta bënte dhe ndoshta edhe institucionin, edhe kryesuesin, edhe kryetarin, por edhe të tjerët. Kryetari, kryesuesi dhe nënkryetari janë të ndërrueshëm, por po flas si emërtim. Do t’i kishim liruar dhe do të ishim në formën më të mirë të mundshme dhe në paraqitje. Unë e falënderoj drejtorin e kulturës për punën që ka bërë. Kjo nuk mundet me shku me marrë shikues, por ajo çka është me rëndësi, thelbi për çka festohet dhe manifestohet, unë konsideroj se i plotëson të gjitha atributet të jetë një manifestim kulturor-sportiv që është shumë i njohur jo vetëm në Kosovë, por edhe jashtë Kosovës. Por do të ishte shumë më i kompletuar sikur 26 familje të renditen aty.

z.Labinot Bislimi: Nënkyetar, as unë nuk dua me polemizu, por ajo çka na dallon është se ju mendoni se përmes akteve normative mbahet shoqëria ose krijojmë dinamika. Aktet normative nuk janë politika publike, janë vetëm akte. Nuk e bëjnë atë, as ndjenjën, as dinamikën e shoqërisë. Prandaj është shumë me rëndësi që ne me u kthi te politikat që ndjekim në kuptimin dhe politikat janë edhe konferencat, organizimet, debatet publike, sepse ato e formësojnë shoqërinë, i japin dinamikë, e bëjnë që të kemi një sens të përbashkët të gjërave dhe jo pse ti e qet një rregullore në nen dhe e bën një publikim një herë. Kjo i mungon Vitisë. Nuk është qëllimi me bë debate të ashpra ose me qenë kundër njëri-tjetrit, por kur flasim për debat është me pas jo vetëm një ndërtim të përbashkët të sensit të shoqërisë, të botës, konceptit etj., por edhe qysh me ia përçu qytetarëve një gjë të tillë. Dhe kjo i mungon Vitisë. Dhe ne do ta kishim ndihmu shumë drejtorin e kulturës në këtë rast për organizimet e ardhshme, por jo tu bë rregullore. Rregullorja për mua është e fundit, ose është ajo e ndërmjetme, e cila në një mënyrë i paraprin dinamikës së ardhshme, por në të njëjtën kohë është ajo që e pret dinamikën për me mrrë deri aty të debateve të cilat na qojnë në këtë drejtim. Prandaj jemi ku jemi sot, që domethënë pas 26 vjetëve ju keni vendos rregullore. Dita e 5 Majit është e vërtetë, ka qenë edhe propozim i Matës që e ka pas vendos, por prap qytetari, këto ndasi, ky perceptim i llojllojshëm i dëshmorit, homazhit, mënyrave, formave, po mbetet. Domethënë që realisht aktet e bëjnë atë punë, e bën drejtoria, e bëjmë ne dhe përmes debateve publike, dhe këtë jam tu e kërkë sinqerisht, dhe i ndihmon me të vërtetë vendit.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Unë thashë që debat po, por ta quajmë konferencë konsideroj që konferenca mbahet zakonisht kur ka rrethana të panjohura. Tek ne asgjë nuk është e panjohur, kërkon vetëm mirëkuptim dhe atë mirëkuptim duhet ta normojmë. Unë besoj që çdo shoqëri normimi i bën rregull, dhe pikërisht për këtë thashë që debate mund të ketë, por të organizohet një konferencë rreth këtyre datave besoj që nuk e ka kuptimin e vet. Unë nuk pajtohem me të, se në konferencë dilet kur sjell risi që opinionin nuk i ka ditë. Këto ngjarje të gjitha dihen, edhe datat e rënies së dëshmorëve, edhe zanafilla e “Flakadanit të Karadakut”, edhe organizimi tash si i kemi. Prandaj thashë që nuk kam propozu rastësisht me kryesuesin që të jetë një rregullore që do të ketë debat të mirëfilltë, që me qenë i zbatueshëm, edhe që mos të preket asnjë familje, të përfshihen të gjitha ato që kanë kontribuar dhe të jemi unik në datat e manifestimit.

z.Labinot Bislimi: Pa e zgjatë debatin, mos të kapemi për fjalë në kuptimin konferencë apo tavolinë pune, apo ta quajmë si të duam. Me rëndësi është që ne si njerëz, në kuptimin si Kuvend, si drejtori, edhe si qytetarë, si familje të dëshmorëve, si organizata, me u ulë rreth një tavoline pune ku faktikisht arrijmë dhe mbërrimë te

ajo rregullore e punës. Aty duhet me u bërë debat. Besoj që nuk është mirë me përkufizuar debatin vetëm në një Kuvend. Ne duhet me zgjeruar debatin publik. Vitisë është tu i munguar hapësira publike. Kurdo kush që e njëjtin nocionin dhe e ka studiuar se çka është hapësira publike, e di që hapësira publike nuk është shesh. Ti mundesh me bërë shesh sa të duash, por qytetari nuk është i informuar, i involvuar, i integruar në debatet institucionale. Edhe konferenca, kur e the që merret me diçka të panjohur, unë nuk besoj që i kemi të njohura të gjitha në lidhje me dëshmorët dhe me këto tematika. Jam i bindur që del shumëçka e panjohur, jo në kuptimin e fakteve, por në kuptimin e konceptit. Prandaj, unë mendoj që debatet nuk duhet me u kufizuar përbrenda katër mureve dhe me një kamerë e cila e transmeton live, por duhet me të vërtetë që qytetarin me involvuar në debatin publik. Sot Vitisë i mungon hapësira publike, sepse ne e kemi shtypë dhe e kemi reduktuar këtë hapësirë publike. Prandaj edhe ma vonë vjen te puna e numrit ku diskutohet, sepse qytetari dalëngadalë është i përjashtuar prej shumicës së debateve apo të dinamikave të hapësirave publike.

z.Ekrem Abazi: Përsëritet për të gjithë të pranishmit. Nuk dashta me u kyç në këtë pikë, se është pikë e ndishme, por sa i përket madhësisë, domethënë numrit të shikuesve që kanë dalë në “Flakadan të Karadakut”, kjo ka ndodhë që nga fillimi. Nuk ka ndodhë vetëm tash që po i thonë drejtorit pse. Drejtori u mundu me çdo kusht me kaluar sa më mirë. Bile është një ndër drejtorët më të suksesshëm që ka pas deri më tash Komuna jonë. Por, në fillim unë personalisht kam kërkuar që mos të jetë “Flakadani i Karadakut”, por të jetë “Flakadan i Karadakut – Dëshmorët e Vitisë” në shumës, por nuk kam pas përkrahje nga askush. Këtë e dinë zv.kryetari shumë mirë. Dhe që nga fillimi familjarët e dëshmorëve kanë qenë të pakënaqur me njëjës, jo shumës. Po tash konferenca dhe këto për mua nuk kanë kurrfarë ndikimi, as nuk ka nevojë konferenca, as debate. Këtu pikë së pari, shoqërisht, miqësisht, me biseduar me familjarët e Njazi Azemit, me prindërit ose vëllezërit e tij. Ky është faktori numër një. Mundet me qenë mos me u bërë një mosmarrëveshje, ata me kërkuar që të bëhet në shumës. Ne në fund mundemi vetëm me votuar, me shtuar në statut që të bëhet në shumës, por kurrësi pa pëlqimin e familjes së tyre me bërë këtë debat. Se atëherë bëhet debati hala më i rreptë se që ka qenë në fillim. Domethënë, po e përsëris, që nga fillimi madhështia të njerëzve kurrë nuk ka pas në këtë manifestim. Faktor kanë qenë familjarët e dëshmorit, që shumica nuk kanë ardhë fare, as tash nuk vijnë. Për atë kohë unë kam qenë i vetëm, nuk më ka përkrah askush dhe ka mbetur kjo. Edhe nëse vazhdon kështu, në shumës prap vazhdon, bëhet në shumës me siguri. Salla nuk ka me i nxanë, se familjarët e dëshmorëve nuk janë një, por janë shumë.

z.Jakup Demiri: Nuk dashta me folë, por pasi që është bërë temë në Kuvend, edhe unë po i flas disa fjalë. Ne për këtë temë kemi folë në KPF, krejt jemi të një zëri, edhe këtu i ndegjova të gjithë çka thanë. E kuptoj që kjo temë është e ndjeshme, po megjithatë ne jemi këtu të cilët e rregullojmë këtë. Nuk e rregulloj këtë pa ju bërë një kërkesë, apo pa iniciuar ne këtu. As shoqatat e dala nga lufta, familjet e dëshmorëve, askush tjetër. Ne jemi ata të cilët e rregullojmë këtë problem dhe nuk është pak problem. Labi e dha idenë, na mund ta bajmë një punëtori, një konferencë shkencore profesionale, edhe familjet e dëshmorëve, shoqatat edhe familjen e Njazi Azemit të diskutojmë, ta caktojmë një ditë dhe i kishim dhanë epilog. Por kur po ju ikim temave të ndjeshme, përfshi edhe veten këtu, veç se na e hekim këtë barrë edhe të tjerëve edhe vetit.

z.Illir Zuka: Në mbledhjen e KPF-së, kur na ka ardhë statuti, unë po çuditem me njerëz që po ndryshojnë brenda ditës. Unë kërkoja, e kam kërkuar edhe në vitin 2022, me shtuar një drejtori shtesë. Kam kërkuar në bashkëpunim me shumë familje të dëshmorëve që me shtuar këtë. Atë ditë në KPF kërkoja që ta rregullojmë me statut këtë dhe unanimisht keni qenë të gjithë tu e bashkangjitur, edhe Jakupin e dimë problemin. Nuk mundemi me zgjidhë, me jau lanë shoqatave të dëshmorëve. Nuk kemi kërkesë prej tyre, vazhdojmë kështu. Po këta njerëz jemi, po ndryshojmë brenda ditës. Personalisht kam kërkuar, kam pas debat edhe me familjen e tyre, kam pas debat edhe me ish-kryetarin e Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Nuk ka lidhje çka diskutoni personalisht. Çështje personale kjo nuk ka të bëjë me askënd. Mundet me dhanë propozim dikush, e ke kërkuar në KPF, por nuk është vendimmarrës, është rekomandues. Ka pasë debate publike, ka qenë 30 ditë statuti në debat publik. Asnjë kërkesë nuk ka ardhë, as prej familjes, as prej kujt. Edhe në Kuvendin e kaluar ka qenë debat 1 muaj dhe aty nuk ka pasë asnjë kërkesë. Të gjitha kërkesat që kanë qenë, kanë ardhë edhe në KPF, edhe në Kuvend.

z.Jakup Demiri: Më së pari, nuk është veç Iliri aty, janë edhe disa dëshmitarë të tjerë. Nuk është e vërtetë, ka edhe procesverbal dhe po don me u bë baba i kësaj teme, i fundit je. Ka pasë njerëz para teje që e kanë rrahë këtë temë, i fundit je. Dhe aty sen nuk është, aty jep rekomandim. Këtu propozojë, mblidhi nënshkrimet, krejt në rregull je, ama mos thuaj që po ndryshojnë njerëzit brenda ditës. Kush ta ka dhënë atë licencë me i matë njerëzit? Unë këtë e kam temë të ndishme, se kam edhe vetë dëshmor. Unë e di çka është me bë iniciativa dhe me të lanë njerëzit në rrugëtim. Ne kemi marrë iniciativa se na kanë lanë në rrugëtim. Për atë unë nuk po du me folë, se kur të është puna me vendos diçka, hijë i ke përmas. Këtu është vendi me vendos, askund tjetër. Ne duhet me nisë obligimin. Obligimi i jonë është Statuti i Komunës, ne e bëjmë, nuk e bën askush tjetër. Ti edhe të gjithë të tjerët që nuk kanë familje të dëshmorëve e keni ma lehtë. Ne kemi edhe problem brenda në familje, ndryshe e keni ju dhe ndryshe e kemi ne.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Krejt për afërsisht të njëjtën gjë jemi tu e diskutu. Nuk ka këtu për herë të parë kush u marrë e jo, por në këtë, në çdo rregullore, statut, vendim, ka të bëjë edhe me diskutim publik. Bëhet diskutimi publik dhe diskutohet me grupin e interesit të caktuar. Datat e dëshmorëve diskutohen edhe me shoqatat e familjeve të dëshmorëve. Nuk mundesh me marrë vendim individualisht pa diskutu me ta. Pas 26-27 viteve, një datë me u ndryshu, me u bë ndryshe, nuk është bash lehtë. Duhet me diskutu me të gjitha shtresat dhe me ardh propozimi i harmonizum dhe me kalu. Nëse ne mendojmë si Kuvend edhe në çështje të ndishme me ndryshu ne, pse e bëri dikush një propozim, gabim më i madh është edhe me mendu në këtë drejtim. Këto punë, tek datat dhe tek familjet e dëshmorëve, shkojnë në mënyrë të harmonizume me familjet, me shoqata, me Kuvend, dhe diskutojmë dhe e mbyllim. Ne këtë jemi tu e lypë: me diskutu dhe me u kry.

z.Ilir Zuka: Jo rastësisht e bëra pyetjen, shumë të sinqert, drejtorit të DKRS-së, një krahasim të shikueshmërisë të 3 aktiviteteve më të mëdha të Komunës së Vitisë. Edhe e dyta, u lidha me asambleistin e VV-së. Shumë është e rëndë me të ardh puna në Kuvend me folë për prindin tanë, kur ai e ka kry punën tjetër kun e dimë kontributin që e ka dhënë dhe jetën për liri, dhe ja kemi pru punën një djalit të dëshmorit me bë një kërkesë të tillë. Jo, se ne e kemi gjetë të tillë këtu. Kam qenë prej ditës së parë kryesues, e kam diskutu edhe me ty, edhe me shumë të tjerë. Nuk është që e kam ditë dhe që jam më i ndishmi, por mua më ka rastis me pas me familjen e dëshmorit të Pozheranit një raport shumë të ngushtë dhe i kam ditë problemet nëpërmjet tyre.

Për atë kam kqyr të paktën diçka me bajtë, dhe krejt kjo ka qenë. Asnjëherë nuk ka qenë me mbetë unë. E propozova larg asaj. Mirëpo, shumë e dhimbshme kur me një turnir të marrin 10 mijë vetë me kqyr atë, dhe kur të përfundon ai në tubimin tjetër të marrin pjesë veç shoqëritë kulturore artistike.

z.Ekrem Abazi: Kam një lutje për zv.kryetarin edhe kryesuesin e Kuvendit, që ju dy ose kryetari i Komunës të bisedoni lidhur me “Flakadanin e Karadakut” me prindin e Njazi Azemit, me bind ju atë që ai me qenë vetë inicues i kësaj pune edhe me familjarët e dëshmorëve. Puna më e mirë është kjo çka po thojmë këtu, me vendos, se ne e vendosim, nuk jemi kundër saj, por është mirë kjo me kalu në mënyrë më të kulturume, më të qetë dhe ai me propozu vetë. Besoj që e propozon dhe është mënyra më e mirë e zgjedhjes së këtij problemi. Nuk ka lidhje kush e propozon atë punë, veç me kalu mirë, se ne në Viti jemi rreth i ngushtë, krejt jemi të njoftun mes veti. Edhe sukses shumë i madh është prindi ti me u qu, është si iniciativë: e kam fillu që mos të jetë “Flakadani i Karadakut” vetëm për fëmijën tem ose për familjarin tem, por të jetë për të gjithë dëshmorët e Komunës së Vitisë. Atëherë këto punët tjera janë shumë më të lehta me i kry. Nëse kjo kryhet me sukses, këto tjerat as nuk kemi çka bisedojmë ne. Bile është turp me diskutu më gjerë. Ne veç duhet me bë amin, po shumë e qartë.

z.Labinot Bislimi: Është e vërtetë ajo që po e thotë kryesuesi, jemi pak a shumë prej të njëjtës vijë, po pastaj kur po themë që ja vlen me hapë debatin me një konferencë apo me një takim të vërtetë 1-2 ditor pune, sepse shihet, duket që kemi vërtetë nganjëherë probleme konceptuale. E para, puna e dëshmorit nuk i përket familjes. Prej atij momenti që është bërë dëshmor, i përket kombit. Familja kuptohet që është e nderume në këtë rast dhe për gjithçka, por në aspektin e konceptit janë institucionet ato që e marrin përsipër për me nderu, për me konceptu mënyrën, qasjen etj. ndaj tyre. Kështu që, gjithashtu, dëshmori nuk ka të Vitisë, Deçanit. Dëshmori është gjithmonë i kombit. Kuptohet që ne i nderojmë ata që i kemi më afër, por gjithmonë në aspektin konceptual jemi tu i nderu dëshmorët e kombit. Prandaj, pa u zgjeru më shumë, pa shku më thellë në këto detaje, ne kemi nevojë me u ulë, që tha edhe Jakupi, qoftë edhe konferencë shkencore, për me debatu. Nuk besoj që i takon

babës së Njazi Azemit me vendos se çka ka mu bë në aspektin institucional. Ai duhet me u përfshi, kuptohet, siç e thash edhe më herët, çdo familjar duhet me u pyet, me bisedu me ta, por vendimi edhe në fund rregullorja del prej aspekteve institucionale. Ne prandaj duhet me i bë këto konsultime, po jo në kuptimin me ia lanë çka po thotë baba i Njazi Azemit dhe ashtu me e vendos.

z.Ekrem Abazi: Dëshmori është i kombit, por bash dëshmori është dëshmor i familjes, se ne e dimë sa i nderojmë dëshmorët dhe sa i kemi nderu, sa i kemi respektu, sa kemi punu e çka kemi vepru e bë për ta. Bash nuk kemi bë asgjë, veç kur na kanë vyjtë. Dëshmori është dëshmor i kombit, po bash te e fundit është dëshmor i asaj familjes.

z.Valmir Sahiti, drejtori i DKRS-së: Debati u zgjeru shumë edhe jashtë kësaj informate, por natyrisht me qëllimin e mirë. Unë veç një gjë deshta me thanë, që “Flakadani i Karadakut” është manifestim statutar dhe ne si drejtori jemi të obligum me u sjellë dhe me respektu Statutin e Vitisë. Secili ndryshim që bëhet në të ardhmen, natyrisht kemi me u sjellë ashtu siç e voton Kuvendi Komunal. Por është një e vërtetë e madhe që kjo sallë është e vërtetë, që ka legjitimitetin dhe aspektin legal për krejt ndryshimet me i bë, po te kjo temë është një e vërtetë e madhe që në aspektin praktik ky ndryshim kalon përtej kësaj salle. Sepse, deshtëm apo nuk deshtëm, kjo shoqëri ende jeton në do norma e parime morale përtej politike e përtej institucionale. Kjo është e vërteta që duhet me u thanë troç. Prandaj, në këtë temë unë isha rezervu me folë më shumë, se është një temë jashtëzakonisht e ndjeshme, që 26 vjet pas luftës mundemi me lëndu dikë, ndonjë familje të dëshmorëve, që në asnjë rrethanë nuk ja kisha dashtë askujt. Prandaj, unë edhe një herë, në kuadër të rrethanave dhe kompetencave që kemi pasë, kisha falënderu krejt njerëzit që na kanë ndihmu. Është një e vërtetë që krejt këto mospajtime, këto shqetësime janë të vërteta dhe ne në secilën ditë përballemi, dhe është e vërtetë që na i vështirësojnë edhe punën e organizimit.

z.Jakup Demiri: Drejtor, e di që puna jote është me i zbatu rregulloret dhe rregullat, po the një fjalë që duhet me qenë të kujdesshëm, mos me lëndu dikend. Është e vërtetë që sa herë të folsh ke me lëndu dikend, por heshtja është tu lëndu më shumë sesa që jemi tu folë. Kjo është e vërteta e kësaj.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Faleminderit për kontributin e dhënë në këtë pikë. Kjo pikë është veç informatë, nuk del në votim.

Pyetje dhe përgjigje

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Pasi që kemi 2 mbledhje sot, mendoj që kjo pikë të shkon veç në njërin mbledhje, nëse doni në këtë ose në tjetrën.

z.Jakup Demiri: Nuk e di rregulloren, a kemi të drejtë me i mbajtë 2 mbledhje brenda ditës, por sido që të jetë, ne e shkelim rregulloren nëse nuk e zbatojmë këtë pikë të rendit të ditës. Ne kemi votu këtë pikë të rendit të ditës dhe unë jam për me vazhdu.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Nuk jam tu kërku me hjek, po me vazhdu veç në njërin mbledhje. Çka janë pyetjet, i shtroni në këtë seancë. Hapi diskutimin për pikën pyetje-përgjigje.

z.Elsa Jahija: Përsëendetje për të gjithë të pranishmit. Nënkrëtar, sot dua ta ngre një çështje e cila tash e një kohë të gjatë vazhdon të paraqesë një barrë të konsiderueshme financiare për Komunën e Vitisë, por edhe për shumicën e komunave në Kosovë. E kam fjalën për obligimet që burojnë nga kontratat kolektive dhe ekzekutimin e vazhdueshëm të tyre përmes procedurave përmbartimore. Si pasojë e kësaj, Komuna e Vitisë po përballlet me vështirësi të konsiderueshme financiare, të cilat po ndikojnë jo vetëm në realizimin e projekteve të planifikuara, por edhe në sigurimin e financimit të nevojave elementare për funksionimin e rregullt të administratës komunale. Duke pasur parasysh ndikimin që kjo çështje ka në menaxhimin e financave komunale, konsideroj që është shumë me rëndësi për qytetarët, por edhe për ne si anëtarë të Kuvendit Komunal, të kemi një pasqyrë të qartë lidhur me këtë çështje. Prandaj, pyetja ime konkrete është: a ka Komuna e Vitisë, respektivisht ju si lidërsip komunal, një pasqyrë të saktë mbi shumën e përgjithshme të obligimeve të papaguara që burojnë nga kontratat kolektive dhe a ekziston një planifikim apo afat i përafërt se kur pritet të përfundojë ky proces, i cili po vazhdon të rëndojë buxhetin komunal dhe të kufizojë kapacitetin e komunës për realizimin e projekteve dhe përmbushjen e obligimeve tjera ndaj qytetarëve?

z.Illir Zuka: Në rrugën Sylejman Aga, që është rruga më e frekuentume në Pozheran, për shkak që lidhë xhaminë aty dhe është degëzim i rrugës Sinan Terziqi, është pre asfalti si me hapë pishinë. Po e pyes drejtorin, a kanë marrë leje ata që e kanë pre? Rruga ka qenë shumë mirë. Besoj që drejtori i Shërbimeve Publike e ka një informatë dhe na tregon.

z.Jakup Demiri: Rreth trotuarit në Trestenik dhe në Smirë, a do të përfundohen këtë vit? Kam mbajtur takim me disa prej banorëve të Trestenikut dhe gjendja është që është viti i 6-të që ka fillu. Tash e 4 vite janë disa anësore, disa janë vendosë e disa jo, që janë bërë pengesë, edhe bari është rritë, është bërë rrezik edhe për njerëzit. Edhe në Smirë, jo që ka shumë punë, ka pak punë ka mbetë. A do të përfundohet apo nuk përfundohet? Unë personalisht po du me marrë një aksion në fshat dhe me përfundu, se vende-vende është rrezik për fëmijët që shkojnë në shkollë. Dhe rruga në Sllatinë të Ulët, gjatë gjithë rrugës anës së majtë, Viti-Sllatinë e Ulët e Epërme, gati gjithë fshatit kalon, që është kanali i hapur. Është shumë i rrezikshëm. Ajo gjithashtu ka qenë, por paramendoni me ra vetura këtu, nuk ka as sinjalistikë. Këtu duhet një investim për siguri, se është i rrezikshëm për ndonjë fatkeqësi, ndeshje apo vetëaksident. Edhe sipas inxhinierëve të komunikacionit, të gjitha këto, sa kanë thellësinë dhe këto që janë, janë vdekjeprurëse për banorët apo njerëzit që qarkullojnë me vetura. Ja vlen me qenë si prioritet kjo, se janë të rrezikshme.

z.Ekrem Abazi: Çfarë veprimi keni bërë ju si komunë për sanimin e gjendjes së Muzeut të Qytetit, që së paku qe 1 vit e më tepër ka fillu të shkatërrohet? Përbrenda aty, veç 1 katë ka hy gati në dhe. A ndoshta po doni me shkatërru krejt?

z.Elham Emërllahu: E kam parë kolegun tim Nuhinë nga PDK që ka bërë një mal kërkesa para disa javësh për disa punë që duhen të kryhen prej komunës dhe e përkrah. Nuk e di a ka marrë përgjigje, por ajo që mua më ka shqetësuar kohëve të fundit është që Verbani, nga 4 vitet e kaluara nga ekzekutivi dhe nga ky koalicion që është sot, çuditërisht ka qenë shumë mbrapa me investime kapitale. Nuk e di pse. Edhe ato kërkesat që ka pasë Nuhia, edhe këto të cilat unë dua me i ngritë, janë jetike për Verbanin. Mandati 2021-2025 për Verbanin ka qenë mandat i humbur. Për besë, nuk di që ka pasë ndonjë investim që duhet me e theksu dhe ju qëndroj mbrapa kërkesave që ka bërë Nuhia. Krahas kësaj, është një kërkesë për drejtorin e Urbanizmit për lejimin e një hapësire në hyrje të fshatit. Është hapësirë komunale e cila duhet të jepet në shfrytëzim, sepse ka një iniciativë për ndërtimin e një obelisku të UÇK-së në fshatin Verban. Për keqardhje, nuk e di pse kaq gjatë Verbani, si lokalitet i cili ka bartë barrën e organizimit ilegal dhe të luftës së UÇK-së, mos me pasë një obelisk të tillë. Por ajo është edhe çështje e fshatit. Na duhet një hapësirë komunale dhe ajo është e identifikume. Besoj që edhe drejtori i Shërbimeve Publike e dinë, që bashkë me drejtoreshën e Urbanizmit të na sjellin për seancën e ardhshme që ajo pronë të na jepet për shfrytëzim. Ndoshta më vonë ka nevojë me intervenu diçka, por iniciativa dhe nënshkrimet prej fshatarëve veç kanë fillu me u mbledh për atë hapësirë. Dhe pyetja tjetër, e di që është diskutu edhe mandatin e kaluar, se e kam përcjell Kuvendin Komunal, është problemi i parkingjeve në Komunën e Vitisë. Me të vërtetë, në aspektin gjeografik dhe strategjik, Komuna e Vitisë ndoshta e ka pas mundësinë më të mirë me kriju parkingje publike, ndoshta edhe nëntokësore, sesa shumë komuna tjera të Kosovës të cilat i kanë bërë. Mua më ka ra rasti me pa edhe Komuna e Shtimes që ka bërë parkingje publike, e mos të flasim për Malishevën që ka bërë një parking nëntokësor me standarde evropiane. Lipjani e ka bërë. Nuk e di a ka planifiku Komuna që të paktën në 4 vitet e ardhshme me siguri diçka për parkingje. Tash sidomos kur të vijnë mërgimtarët, është problem mungesa e parkingjeve.

z.Remzi Salihu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. z.drejtor, sot kam një pyetje lidhur me aktivitetin e qendrave shëndetësore nëpër fshatra të Komunës së Vitisë, por konkretisht për Qendrën Shëndetësore në Zhiti. Sa është funksionale kjo shtëpi e shëndetit, si menaxhohet dhe nga kush? Nëse përgjigjen do ta marrë pa ekuivok, pyetja është e plotë. Nëse jo, atëherë kam edhe 50% në mbledhjen tjetër.

z.Basri Aliu: Kam një kërkesë nga qytetarët te rruga “Dëshmorët e Kombit” dhe rruga “Ilvi Demiri”. Disa qytetarë më kanë shkru si kërkesë për pastrimin e rrugëve nga barishtat, por edhe ndriçimi ka nevojë për intervenim. Tjetra është te investimet kapitale. Në qytetin e Vitisë, rrugët lagjore, të cilat janë afër 40 ose mbi 40, janë të paasfaltuara dhe qytetarët po kanë shqetësim në këtë drejtim. Kjo për shkak që po shohin tu u ndërtu rrugë të asfaltuara nëpër kodrina, nëpër fusha, ndërsa po thonë ne që jemi këtu prezent, që po jetojmë, që janë

rrugë të frekuentuara çdo ditë, nuk po kemi mundësi me i shfrytëzu. Prandaj, kërkoj nga Drejtoria e Financave dhe nga Kryetari që këto rrugë t'i parashohin në buxhetin e sivjetëm, edhe pse disa janë parapara paraprakisht. Fakti është që kanë nevojë, sepse për disa që i di, kemi intervenu shpesh me zhavorr, por ato ende janë të paasfaltuara.

z.Lulzim Haxhiu: Kam një pyetje për tregun e gjelbër, i cili ndodhet në gjendje të mjerueshme dhe nuk i plotëson kushtet elementare për zhvillimin e aktivitetit. Si pasojë, shumë tregtarë janë të detyruar ta zhvillojnë aktivitetin e tyre në trotualet e rrugës, duke rrezikuar sigurinë e këmbësorëve, të nxënësve të shkollës “Bafti Haxhiu”, si dhe duke krijuar pengesa dhe kolona në komunikacion. Çfarë masa konkrete do të merrni për zgjidhjen e këtij problemi dhe kur pritet të krijohen kushtet e përshtatshme që tregtarët të vendosen brenda tregut?

z.Nuhi Ramadani: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Pata edhe unë pyetje për Trestenikun. Atje ka fillu një trotuar në vitin 2021, në shtator bëhen 5 vite, dhe ka mbetë në gjendje të mjerueshme. Banorët po pyesin çka ka ndodh me trotuarin dhe kur ka me përfund, se me të vërtetë është interes prej banorëve me u rregullu sa më parë që është e mundur. Sa i përket kërkesave të mia që i përmendi Elhami, unë kërkesa kam bërë dhe kam me bë edhe në të ardhmen, se është në interesin tim dhe për këtë jam këtu. Kanë fillu disa ndriçime me u realizu, për çka e falënderoj drejtorin. Tjerat gradualisht, nuk do të thotë brenda një dite, por kërkesat do të jenë aty dhe do të bëjë prap.

zn.Mirjeta Hamiti: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. A planifikoni Komuna e Vitisë që në buxhetin e vitit 2027 të ketë mbështetje financiare për lehonat, ashtu si kanë fillu disa komuna në Republikën e Kosovës? Dhe pyetja tjetër: a ka shpresë për trotuar rreth shkollës në fshatin Drobesh? Është nevojë elementare.

znj.Ardita Hajdari: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Kam një pyetje lidhur me një kërkesë të kahershme të banorëve të Lubishtës. Asfaltimi i rrugës Lubishtë-Podgorc është një kërkesë e kahmotshme e banorëve, është premtuar ndër vite, por deri më sot nuk është realizuar. Kjo rrugë ka rëndësi të veçantë për banorët tanë, kur e dimë që janë 90 burra të masakruar në atë rrugë dhe janë të varrosur aty. Andaj, pyetja ime është: pse ende nuk ka filluar realizimi i këtij projekti dhe a është i paraparë ky projekt në buxhetin komunal?

zn.Lindita Demelezi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Pajtohem me Jakupin lidhur me rrugën Sllatinë-Viti, sepse është e rrezikshme dhe pa sinjalizim. Kisha kërku me ditë, a ka pranim teknik? Dhe tjetra, i nderuari nënkryetar, me datën 27.03.2025 unë kam kërku që të rregullohet koeficienti i punëtorëve publikë. Më jeni përgjigjur se është formuar komisioni dhe së shpejti do të rregullohet. Pyetja ime është: a do të rregullohet ky koeficient më në fund, apo do të shkojë me vite të tjera, kur e dimë që nga 1 korriku paga minimale do të jetë 500 euro? A do t'i lëmë këta punëtorë me pagë minimale, pasi e dimë që këta punëtorë paguhen me pagë 500 euro?

z.Basri Aliu: Dhe një kërkesë ka qenë e qytetarëve të Budrikës. E di që është një kontratë për hapjen e kanaleve, sa është valide nuk e di, a është përmbush apo jo, por kërkesa e tyre është që kanali që është mes Budrikës dhe Remnikut, për shkak të vërshimeve, të pastrohet dhe të hapet ai kanal.

z.Elham Emërllahu: E pata një lëshim të vogël. Kërkesa për lejimin e hapësirës në Verban duhet t'i drejtohet Drejtorisë së Gjeodezisë dhe Kadastrit. Po atë drejtoreshë nuk e shoh kurrë në seancë dhe kërkoj falje znj. Zyrafete, se ndoshta e ngatërrova drejtorin. Nuhi, unë i dhashë përkrahje kërkesave që i ke pasë ti, po unë diskutova për periudhën 2021-2025. Nëse ka pasë ndonjë projekt që vlen me u theksu prej vitit 2021 deri në vitin 2025, unë jap përgjegjësi publike. Nuk thash që nuk janë vendosë disa drita tani prej Drejtorisë së Shërbimeve Publike, por rrjeti ka qenë më herët, shumë herët është bërë rrjeti për ndriçim publik në Verban. Tash është shtru rruga te përmendorja “Kemajl Azizi”, por unë fola për periudhën 2021-2025. E mora si bazë që në këtë kohë me u kry këto punë që i pata si kërkesë.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Pjesa e kërkesës edhe për parcelën, zakonisht shkon përmes planit të interesit të përgjithshëm. Bëhet kërkesa në formë zyrtare dhe harmonizohet me planin zhvillimor, dhe është procedurë që kalohet mirë.

z.Illir Zuka: Kemi pasë ankesë prej banorëve të fshatit Budrik për turbullimin e lumit. Kërkoj prej Inspeksionit me shiku se a është lidhur ndonjë fabrikë, se të njëjtin problem e kemi pasë edhe në Pozheran, por

e kemi rregullu. Dhe një kërkesë për drejtoreshën e Urbanizmit: një pjesë e numrave në Pozheran nuk janë përfunduar nëpër shtëpi. A e keni këtë informatë dhe a do t'i sillni numrat?

z.Nuhi Ramadani: Elham, të tregova kërkesat që i kam bërë. Kanë fillu, ka pasë ndriçim më herët, nuk u diskutua. U diskutua për këtë vit që kemi fillu tash e tutje.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Faleminderit për pyetjet dhe kërkesat e qytetarëve.

z.Arton Musliu, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike: Përsëritet për të gjithë të pranishmit. Përkritazi me pyetjet që u parashtruan prej këshilltarëve komunalë, përgjigjet janë si në vijim: Lidhur me prerjen e rrugës në Pozheran, Ilir, Drejtoria e Shërbimeve Publike nuk ka pranuar kërkesë për pajisje me leje, kështu që nuk ka leje. Lidhur me parkingjet publike që e ngriti Elhami, ne parkingjet publike i kemi shti në kuadër të ndërmarrjes së re publike, për të cilën e kemi marrë vendimin nga Ministria për ligjshmërinë e procesit dhe jemi në proces të punës. Kemi formu ekipin e punës për përgatitjen e dokumentacionit për aplikim. Te rruga “Dëshmorët e Vitisë”, z. Basri, unë vazhdimisht kam kërkesa për atë rrugë. Ekipi i mirëmbajtjes së ndriçimit publik dy herë e ka rregullu ndriçimin publik aty, mirëpo dikush, që nuk e di kush është, është tu e ndalë ndriçimin publik. Nuk kemi mujtë me e identifikuar, se policia nuk ruan për me bërë atë punë. Mirëpo, ne jemi në krye të detyrës, e kemi rregullu dy herë dhe jemi të gatshëm me rregullu prapë. Mirëpo, nuk është problem i mosfunksionimit, më shumë është problem që dikush është tu e ndalë natën, dhe ua kam tregu edhe qytetarëve të asaj ane. Lidhur me prrockat, ne i kemi pastru disa prrocka në Skifteraj, Remnik e kështu me radhë. Besoj që përgjatë kohës kemi me e adresu edhe këtë kërkesë. Një kërkesë e tillë aktualisht nuk është në drejtorinë tonë. Sa i përket tregut të gjelbër, unë pajtohem me ty me atë që është parashtru, mirëpo zgjidhjen e qëndrueshme mundemi me pasë vetëm kur ta themelojmë ndërmarrjen publike, për shkak se aty e kemi parapa si përgjegjësi edhe menaxhimin e tregjeve. Besoj që atëherë e zgjidhim këtë çështje. Aktualisht nuk kemi zgjidhje.

z.Lulzim Haxhiu: Drejtor, ti po thua që nuk kemi zgjidhje aktualisht, por problemi është që ka me ecë në trotuar, jo në rrugë, jo prej kolonave. A ka inspektor kjo komunë që delë dhe i shtinë brenda tregut? Ka me kalu, unë i kam bërë gjysmë ore deri në shtëpi prej Vitisë dhe me e dërgu fëmijën në shkollë. Prej kolonave, fëmijët nuk mundën me ecë në kam.

z.Arton Musliu, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike: Po të kuptoj, i nderuar, mirëpo këto janë edhe përgjegjësi të Drejtorisë së Inspeksionit për mënyrën se si funksionon dhe për shitësit ambulantë që janë. Unë aktualisht, si drejtor i Shërbimeve Publike, nuk mundem me të dhanë përgjigje që ty të kënaq. Aktualisht, Drejtoria për Shërbime Publike nuk ka zgjidhje adekuate për tregun e gjelbër. E kemi futë në kuadër të përgjegjësisë të ndërmarrjes publike lokale që kemi me themelë dhe në momentin që e themelojmë e zgjedhim në mënyrë të qëndrueshme dhe afatgjatë. Aktualisht, situata është kjo që është.

z.Basri Aliu: Drejtor, është kërkesë e banorëve që duhet me u intervenu sa herë që ata kërkojnë, aq sa ke mundësi, edhe për barishtat. E di që ke vështirësi, e di që disa nuk janë në kompetencat tua, se ndriçimi ata e kanë lanë te menaxheri dikush tjetër, nuk është në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, prandaj thash që i ki vështirësitë. E dyta, nuk ka të bëjë me ty hapja e kanaleve. Kontrata është te Investimet Kapitale. Për atë thash që nuk të bëra ty drejtor pyetjen, ka ti fare. Ajo është një investim më i madh se sa që e ke ti kontratën.

z.Ilir Zuka: Drejtor, a pritet me u rregullu se ajo rrugë është e frekuentume, për shkak që është xhamia? Mandej, me u marrë Drejtoria e Inspeksionit me dëmin që e ka shkaktuar. Ne duhet me e rivitalizuar atë rrugë.

z.Halil Musliu, drejtor: Unë që kur kam startu, prioritet ka qenë rifunksionalizimi i sistemit primar dhe avancimi i atij sistemi. Ambulanta në Zhitë nuk funksionon që nga viti 2010 dhe jemi tu e analizu situatën, për shkak që nuk janë tregu shumë të suksesshëm me kalu me hapë qendra të mjekësisë familjare në lokalitete të mëdha, në mënyrë që këtë fluksin me zvoglu që po krijohet në sezona të caktuara në Qendrën Kryesore. Por për krejt këto ekzistojnë disa parakushte. Ne nuk mundemi me hapë veç pse kemi dëshirë dhe, në mungesë të deficiteve buxhetore, sidomos viteve të fundit, na kanë pamundësuar. Nuk kemi mjete me bërë diçka të madhe me ndryshu këtë gjendje.

z.Valmir Sahiti, drejtor i DKRS-së: Rreth pyetjes së Muzeut Komunal, sendi parë për me përmissu diçka është me pranë realitetin. Është shumë realiste që Muzeu Komunal, për momentin, është jashtë funksionit. Ka qenë një investim mes CHwB dhe Komunës së Vitisë, 2020–2021, një objekt që ka qenë realisht i vjetër, edhe

dysHEMEJA ka pësu një shembje. Bashkë me nënkryetarin e Komunës, personalisht jemi marrë me këtë çështje dhe jemi tu vazhdu me u marrë. Dy-tri herë kemi qenë edhe në vizitë brenda muzeut, e kemi pa gjendjen, e kemi thirrë kompaninë punëkryese, edhe pse garancioni ka qenë një vit. Ka dalë garancioni, e kemi lutë, me mirëkuptim, me bë një evitim dhe një sanim të asaj gjendje. Nuk e kemi gjetë mirëkuptimin e saj. Jemi duke u mundu që përmes modaliteteve dhe kontratave tjera me zgjidhë atë çështje.

Dhe Muzeun Komunal me e kthi në gjendjen si i takon dhe që duhet me qenë në shërbim të qytetarëve të Vitisë.

z.Ekrem Abazi: Ai muze, për renovim para 5–6 viteve, ka kushtu 24–26 mijë euro. U bë një punë shumë e vogël, shumë e dobët aty. Unë kam reagu në atë kohë. Në podrum uji ka rrjedh. Në atë kohë unë kam reagu në Kuvend. Në podrumin, në anën e kundërt, kanë qenë dokumentet e ish-pushtetit. Ato dokumente dyshoj që nuk janë hjek fare prej atyhit dhe askush nuk u marrë me atë punë. Këtu çdo punë që kryhet, nuk del me kqyr çfarë pune është tu kry. Unë kam dhënë vërejtje. Këta kurrfarë reagimi nuk kanë bë. Para një kohe ka qenë ma pak, tani gjendja aty është ma e randë dhe fajtori aty është Sokol Haliti me bashkëpunëtorët e vet.

z.Lulzim Haxhiu: Pyetja për drejtorin e Shëndetësisë: Barnatoret në orar të kujdestarisë nuk ka në Komunën e Vitisë dhe është kërkesë e qytetarëve se, pas orës 23:00, nuk ka barnatore të hapur në Viti dhe ne detyrohemi si qytetarë me dalë jashtë Vitisë me ble barna. A ka ndonjë marrëveshje me këta biznese apo diçka me bë një orar kujdestarie me rend, ose asaj që është brenda objektit të QKMF-së, që është me qira, që ai me e mbajtë të hapur gjatë orarit të natës?

z.Halil Musliu, drejtor: Për barnatoret është çështje e ekonomisë private, mirëpo ne kemi bisedu dhe jemi në drejtim të një marrëveshjeje dhe ata me funksionu me rend.

zn.Zyrafete Rama, drejtoreshë: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Sa i përket pyetjes së z. Ilirit, kemi mungesë të numrave jo vetëm në lagjen Pozheran, por edhe në disa lokalitete tjera. Kemi bë kërkesa të vazhdueshme në Agjencionin Kadastral të Kosovës, sepse furnizimi bëhet nga aty. Në momentin që furnizohemi, shërbimin do ta marrim me kohë qytetarët e Komunës së Vitisë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Tek çështja e kontratës kolektive, shumë sa na kanë marrë e dimë dhe sa do të na marrin është problem me ditë, se ato lëndë janë te avokatët, përmbauesit etj. Megjithatë, po besoj se jo vetëm Komunës së Vitisë, por mbarë funksionalitetin e komunave në Republikën e Kosovës e ka qitë nga sistemi. Një pyetje për trotuarin Trestenik dhe Smir. Avokatët dhe përmbauesit po na bëjnë shumë problem. Në rast se bëhet zgjidhja me shku te shpia nuk është problem, por edhe ata që vijnë do ta kenë problemin e njëjtë pa përfundu këto borxhe. Rruga Sllatin e Ulët, për kanalin e hapur, do ta shtroj si çështje, sepse është çështje e inspektorëve që e shikojnë dhe aty që ka rrezikshmëri, ndërmarrja e veprimeve për mos me pasë atë çështje. Këshilltarë, që ju drejtu, kërkesat bëhen nëpër drejtori, nuk i bëhen Kuvendit. Drejtoritë e përgaditin e i binë këtu. Në rast se është pronë e Komunës dhe është në përputhje me planin zhvillimor komunal, nuk ka problem. Besoj që do të jetë pozitive. Disa rrugë lagjore të cilat janë të paasfaltuara në Viti dhe disa që po shtrohen nëpër lokalitetet rurale, unë konsideroj frymë duhet me ju dhanë të gjithëve, por qyteti ka një trend të zhvillimit më të shpejtë dhe krijohen rrugë të reja. Ju e dini se motoja jonë ka qenë që asnjë rrugë mos me qenë pa asfaltu, por megjithatë kjo kontratë i ka prish këto çështje. Luli, për tregun e gjelbërt, do ta plotësoja drejtorin në këtë rast. Tregu i gjelbërt nuk do të ishte në atë formë po ta kishim të rregulluar çështjen e pronësisë. Nga ky Kuvend shumë herë ju kemi drejtu dhe kemi miratu listat të cilat kemi kërku nga Qeveria për lirim të atyre pronave dhe mes tyre edhe çështjen e tregut të gjelbërt, që menaxhohet nga AKP-ja, se investim ne s'un bëjmë momentalisht deri sa nuk bëhet ndonjë ndërrim apo ndonjë gja tjetër dhe gjendja nuk është e mirë. Nuh dhe një këshilltare tjetër e PDK-së, unë i kam lexu kërkesat e juaja. Kërkesat e tua, krejt buxheti i Komunës së Vitisë për një vit me u shterr në Verbanc nuk kryhen. Duhet të jemi realistë. Nuk ka kërkesë që nuk është e nevojshme, por Komuna përgjegjësisht shkon në ato kërkesa që janë të domosdoshme me u kry. Në këtë gjendje që jemi duhet me ju japë prioritet shkollave, se nxënësat më 1 shtator duhet të kthehen në mësim. A do të ketë mbështetje për gratë lehona? Individualisht po them unë jam kundër kësaj, jo për tjetër. Duhet të mësohemi ne që çështjet të cilat janë të rregulluara me ligj në nivel qendror nuk duhet të ketë dyfishim, pse mendoj për shkak se, në rast se kemi me rregullu një çështje, duhet të vrapojmë ta rregullojmë një segment tjetër. Për trotuarin në Drobesh nuk mundem me të thanë se jemi në telashe, se po na i marrin parat nga kontrata kolektive. Është viti

i dytë që na ka prish strukturën buxhetore që kemi pasë me realizu në aspekt të investimeve kapitale. Asfaltimi i rrugës Podgorc–Lubisht e di që është me rëndësi për shkak të vetë nderimit të 94 viktimave, por megjithatë do të presim. Në plan e di që është. A ka pranim teknik? Lindita, më duket kanë tregu ata, por nuk e di a ka, se nuk mund t'i mbaj mend. Çështjen e zyrtarëve të regjistrimit civil, të cilën e the, qashtu si të kam thanë atëherë, jemi në proces e sipër. Tash e keni në seancën e ardhshme Statutin dhe pas Statutit rregullohet, dhe gjithçka do të rregullohet. Nuk është problemi vetëm i regjistruesve civilë, ka pakënaqësi të tjera edhe në shërbimin civil. Besoj që do të rregullohet me çështjen e kategorizimit. Turbullira e ujit të Moravës, edhe unë kam qenë dëshmitar, e kam pa dhe në vikend më kanë thirrë. Edhe një televizion është marrë me fabrikën që është në rrugën e Skifterajve, por ai ka pranë me shku televizioni dhe nuk qenka ajo. Prandaj, detyrë e inspektionit është që të hulumtohet se cila fabrikë po e ndot atë çështje. Fabrika që është aty nuk ka asnjë rrjedhje. Këtë informacion kam marrë.

z.Basri Aliu: Nënkyetar, unë e di që çdo kund që investohet është mirë, por prioritet duhet me pasë aty ku ka banorë. Për këtë po e them. Unë i di edhe vështirësitë që janë, por bëna kërkesa që ato të futen në buxhetin e sivjetëm. Telashja është që banorët po shohin tu investu në rrugë aty ku nuk ka frekuentim të njerëzve dhe këtu qëndron problemi, që duhet me ju japim prioritet aty ku janë banorët dhe të kalojmë në investime të tjera. Askush nuk është kundër investimit, por prioritet t'u ipet aty ku janë qytetarët.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Ti, si ish-drejtor, e din mirë se projektet të cilat janë në viset rurale janë projekte të cilat janë fitu nga ana e Ministrisë, ndërsa ti nuk mundesh me konkuru për asfaltimin e 40 rrugëve të shkurta në Ministri. Dhe këtë çështje ke mujtë me shtru, se kryesuesi së bashku me anëtarët e KPF-së, gjatë debatit, dhe asnjë prej juve nuk keni qenë. Unë kam qenë dhe me e shtru si prioritet, si propozim, që në vitin 2027 të ketë prioritet. Unë konsideroj që nuk është të propozohet në Kuvend, se tash kemi me bë propozimin për buxhetin e vitit 2027. Sot nuk jemi tu bisedu për atë çështje, por ka fillu procedura për atë çështje.

z.Basri Aliu: Unë i di, por qytetarët nuk i dinë ato. Atyre ju intereson me pasë rrugë aty ku janë tu jetu. Kemi dhe rrugë që janë shtru prej buxhetit komunal, po flas për ato që janë prej buxhetit komunal. Unë bëra kërkesë që të hyjnë në prioritet edhe në KAB, edhe në investime tjera, sepse ju kemi thanë qytetarëve çdo herë që do t'ua shtrojmë rrugët aty ku janë tu jetu.

z.Nuhi Ramadani: Nënkyetar, unë kërkesat që i kam bërë nuk kam thanë me i kry brenda muajit. Realisht, ato janë vazhdimësi, por urgjente është trotuari në rrugën e Sokolëve dhe rruga Qerim Ramani. Se rruga e Sokolëve që lidhet me Goshicë dhe rruga ka Begraçë, aty është kriju një korridor shumë i rrezikshëm. Në Verbanc kemi kërkesa edhe për ujë të pijshëm, por ende nuk e kam bërë, se kërkon një kosto më të lartë. Duhet intervenim i Qeverisë, se Verbanci është fshati i dytë pas Stubllës, i cili bart ujë me cisterna gjatë stinës së verës.

z.Jakup Demiri: Nënkyetar, unë kërkoja një datë që këtë vit a përfundojnë këto projekte. Këto nuk janë projekte as të vitit të kaluar, as të vitit që kemi problem me kontratën kolektive, por janë projekte shumë më të hershme. Veç thashë, a mundem me garantu unë para qytetarëve që këto projekte përfundojnë? Drejtor Valmir, do të ishte mirë me ia përmend emrin kësaj kompanie, kush është ajo.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Ti e din atë vala e pandemisë, ngritja e çmimeve që ka pasë njëfar shtyrje, se ka qenë ngritja e çmimeve, jo kompensimi nga ana e Qeverisë që ju pat thënë. Dhe tash u shty ajo çështje dhe u ndërpre ajo kontratë, nuk e vazhdoi më, edhe tash na zuni edhe kjo çështja. Nuk deshta historikun me shpjegu, se ti e din barabar me mu, se ke qenë këtu, por gjendja është kjo. Përcaktimi yt që lypë datë, as ti me qenë në vend tem nuk guxon me dhanë. Nuk mundesh me dhanë, veç në rast se Qeveria vendos me i rimbursu mjetet të cilat na i ka marrë, bile të investimeve kapitale, jo tjerat. Ajo kryhet, nuk është problematike. Ne kemi kërkesa të vazhdueshme, por nuk kam informacion që asnjë komunë ja ka rimbursu. Por kam informacione se disa komuna të veta i përkrahën më së shumti, që është normale për mua.

z.Jakup Demiri: Unë kërkoja vetëm sa për datë, por në rregull, e mora përgjigjen. Sa i përket punimeve nëpër projekte, ne kemi pasë edhe rrugën e Sllatinës, që ka pas hjek dorë një kompani për shkak të çmimeve, e ka pas lanë krejt. Dhe tani ajo kompani vetë ja ka vnu çmimin sa e ka krejt dhe e ka pas fitu për së dyti. Ajo e dimë krejt çka ka ndodhë. Veç pak rahmet me pas pas kjo rrugë, ishin kry këto, por kështu shkon dhe kjo nuk

është me fajin tand, po ta them drejt për drejt, por e kanë bërë të tjerët. Drejtor, është mirë me ia përmend emrin kompanisë. Po flas pikërisht për këtë çështjen e muzeut. Para dy viteve e kemi diskutu me pas prioritet, se është objekti tu u rrëzu dhe nuk ka pas veprim konkret. Te çështja e tregut, ka mundësi me disa donacione që kaniherë mundemi me i investu, se është gjendja e keqe dhe rruga që pengohet për me kalu, dhe problemi brenda që nuk është higjienik.

z.Ramadan Deliu: Dua të ndërlidhem te nënkryetari që tha: “Unë jam kundër për nanat lehona”. Unë, jo me mujtë, jo ka 500, po ka 1000 jau japë. Është tu i dhanë Rahoveci, Vushtrria, shumica janë tu i dhanë ka 500, por mos mujtë 500, të paktën 300 me i dhanë. Jemi tu e pa koston sa është bërë me rritë një fëmijë.

zn.Lindita Demelezi; Nënkyetar, së pari më erdh keq që nuk e din a ka pranim teknik a po jo ajo rrugë, se ajo Bbegi është stërgjatë. Por, nëse ka apo nuk ka pranim teknik, apo nuk ka, cila kompani e ka riparuar atë rrugë me zhavor? A keni kërku përgjegjësi nga ajo kompani, pasi që nëse ka të reshura në atë rrugë është rrezik, se aty edhe asfalti dëmtohet kur ka të reshura, e leje ma zhavorri. Dmth, ajo rrugë asfaltit është plotësu me zhavor, dmth është hangër asfalti, është plotësu me zhavor. Duhet me marrë përgjegjësi ajo kompani. Sa i përket koeficientit, siç po shihet, edhe këta punëtorë kanë me ju dërgu te përmbaruesi, sikur punëtorët e arsimit, pasi që është zgjatë shumë.

z.Illir Zuka: Desha me u ndërlidh me nënkryetarin, se po e minimizoni dhe po e bëni sikur kurgja. Ne kemi nisë një trotuar në 2025, në janar, te rruga Haxhi Emini dhe te rruga e Terpezës. Te rruga Haxhi Emini e kanë qytetarët problem me kalu në shpi. Dmth, veç e kemi çel kanalin dhe ka mbetë ashtu. Edhe ai pak zallë që ka ardhë, ka ardhë kompania e ka marrë më vonë, se i kish vyjtë. Ne e dimë problemin. Nuk du me të qitë ty fajtor që i kanë marrë paret e sene, por ti mos e arsyeto kompaninë se janë rritë çmimet. Janar 2025 është nisë trotuari te lagjja Zuka dhe ka mbetë kanal aty.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Ilir, unë nuk e di si po e merrni këtë, po e minimizon. Po unë nuk e kam njet me marrë pushkën me shku me vra. Thashë, kompanitë me rritjen e çmimeve kanë zhagit këtë dhe kanë ardhë deri te ndërprerja e kontratës. Për 2025, tash përmbaruesi i ka marrë paret. Asgjë nuk minimizova, veç që dhashë përgjigje të saktë. Tek mospajtimi i Danit, ti mundesh mos mu pajtu. Ai është mendimi im personal që mendoj se çështja që është e rregulluar një herë nuk ka nevojë me u rregullu dy herë, se kemi probleme të tjera të cilat janë të parregulluara. E thashë në këtë formë, prandaj jo me dashtë me i përjashtu ato nana tona, por atyre ju ka rregullu. Sa është ajo shumë e madhe apo e vogël është çështje tjetër, por është rregullu dhe nuk jam me i dyfishu çështjet, në rast se nënkryetari i Komunës e ka një pagë, mos me pasë edhe një pagë tjetër. Lindita, the që më vjen keq. Mos të vjen keq hiq, se unë jam nënkryetar komune, nuk jam inxhinier me shku me pranu aspektin teknik. Aspektin të cilin e the, a e kemi mush në vend të asfaltit, jo, ajo ka qenë obligim. Nuk ka rrugë të asfaltume që nuk i ka bankinat, mandej të shtruar me zhavorr. Zhavorri largohet, na e qesim apet, për çka është mirëmbajtja e rrugëve verore dhe dimërore. Është bërë shkurtimi i rrugës për me ardhë në Viti në mënyrë fenomenale të mundshme.

z.Jakup Demiri: Paramendo, pranim teknik nuk ka rruga Viti–Sllatinë e Ulët, e cila rrugë prej Ballanit shihet që ka pas dallavere, për shkak se kur kompania i ka ndërpre punimet, ka pas të drejtë 40% të çmimeve. Ashtu e ka parapa inflacioni që është rritë, por ajo t’u ka rritë për mbi 200% dhe e ka fitu prap e njëjta kompani. Ka shku, nuk ka bë asgjë, se nuk ka as pranim teknik. Ky është ai projekt që ka bë çka ka dashtë kompania dhe prap nuk e ka bë mirë. Mas tri jave ke pas grumbuj, pasi është shtru asfalti.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Ne kemi pasë gropa, i kemi shti, i ka renovu. Unë nuk po du me të thanë ty të ka dështu aspekti i nivelit qeveritar. Rruga Gjilan–Klllokot, ku e di sa herë, ta ka pamundësu Remniku–Budriku që dy vite me zorë që hyjmë, dhe në të gjitha rrugët anësore që lidhen me rrugë.

zn.Lindita Demelezi: Nënkyetar, ne jemi tu e drejtu Komunën, jo shtetin. Për Ministri le të flasin ata që janë atje. Ne jemi këtu për Komunën tonë. Rruga është shumë e qarkullushme, e dini edhe ju. Ju e keni shtru. Ne nuk po themi që nuk është shtru, por duhet me u rregullu sikur që duhet. Mua më ka ardh keq kur e kam pa që kamionat po e shtrojnë zhavorrin për rreth me u plotësu asfalti, kur e dimë se çfarë të reshura ka aty.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Pasi që nuk kemi të tjerë për diskutim, faleminderit të gjithëve për kontributin e dhënë në këtë seancë. Mirupafshim në seancën e radhës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:30 min

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi
